



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Priljeno: 15.02.2023		
Njësia Jednica:	Numri Broj:	Shtojca Dodatak:
15-052/01-8464		



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit

Datë:	14.02.2023
Nga:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Për:	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal
Lënda:	Raporti janar – dhjetor 2022 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale

I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal, z.Daut Azemi,

Me anë të kësaj shkrese po ua dërgoj raportin janar – dhjetor 2022 të punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Ky raport për periudhën e lartëcekur, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportimin e Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Shtojcë:

Raporti i punës i Zyrës së Kryetarit dhe drejtorateve komunale janar – dhjetor 2022



KOMUNA E LIPIJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN



REPUBLIKA E KOSOVOS
KOMUNA E LIPIJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPIJAN

Pranuar me: Prilbjen:		
15.02.2023		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
15-052/01-8464		

R A P O R T
I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE
DREJTORATEVE KOMUNALE
JANAR – DHJETOR
2022

Shkurt, 2022

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	5

ZYRA E KRYETARIT

1. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	5
2. Avokatja Publike Komunale	6
3. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	7
4. Njësia për Auditim të brendshëm	8
5. Sektori i Personelit	10
6. Sektori pronësor – juridik	13
7. Zyra Lokale për Komunitete	14

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	15
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	19
3. Drejtorati për Arsim	29
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	39
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	41
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	51
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	53
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	57
9. Drejtorati për Infrastrukturë	59
10. Drejtorati për Inspeksion.....	61
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.....	64
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	67
13. Drejtorati i Prokurimit.....	71

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,
I nderuar kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar këshilltarë, media e ju të pranishëm,

Më lejoni që para jush të prezantoj raportin vjetor të punës të Ekzekutivit të Komunës tonë.

Para se të ndalem në disa pika që ja vlen të referohemi, dua të ua rikujtoj se viti që lamë pas ishte një ndër më të vështirat që kaluam si vend, viti pas-pandemik dhe viti ku inflacioni dhe krizat e vazhdueshme ekonomike e socio-ekonomike gjithësesi kanë reflektuar e po vazhdojnë të reflektojnë edhe në punën tonë si ekzekutiv komunal.

Pavarësisht kësaj, mund të them me përgjegjësi të plotë se ne kemi arritur që ta përmbyllim këtë vit me sukses, ashtu edhe qysh e kishim planifikuar në planin tonë të punës.

Në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore.

Jam i kënaqur me rezultatin e arritur nga Komuna e Lipjanit, ku performanca e mirë në zbatim të ligjit dhe transparencës e llogaridhënies, ka bërë që Lipjani të renditet si komuna e dytë në nivel vendi dhe nga kjo renditje kemi fituar grant në vlerë prej mbi 1 milion euro (1,021,108.38).

Një ashtu komuna jonë është përfituese edhe e 422,351.00 eurove, donacionit nga GIZ – Gjerman, për skemën “Gara për Mjedis të Pastër” si dhe përfituese e dy kamionëve për grumbullimin e mbeturinave.

Komuna e Lipjanit në vitin 2022 edhe zyrtarisht është shpallur fituese e Çmimit Evropian për Ekselencë në Qeverisje (ELOGE), organizuar nga Shoqata Evropiane për Demokraci Lokale – ALDA.

Një ndër objektivat kryesore ka qenë transparenca dhe publikimi i të gjitha raporteve lidhur me menaxhimin dhe shpenzimin e buxhetit, raporteve rreth inkasimit të të hyrave vetanake dhe menaxhimin e pasurisë. Në raportin e fundit të publikuar nga Instituti GAP “Indeksi i Transparencës Buxhetore të Komunave”, Komuna e Lipjanit renditet e para për transparencë Buxhetore. Lipjani bën pjesë në kuartilin e lartë dhe me 100 pikë të grumbulluara është renditur si komuna më transparente. Ndërkaq Komuna e Lipjanit është renditur e dyta, me vetëm një pikë më pak se vendi i parë në “Transparimet Komunal” të publikuar nga KDI.

Më duhet të theksoj se edhe këtë vit e hyra vetanake në komunën tonë shënon progres të jashtëzakonshëm duke tejkaluar planifikimin buxhetor, ku deri në fund të këtij viti në total e hyra vetanake ka kaluar planifikimin fillestar për 23.79%. Kurse totali i tejkalimit me donacione është rreth 39%.

Vlen të theksohet se kemi përfunduar një projekt madhor dhe shumë të rëndësishëm për komunën e Lipjanit, objektin e administratës komunale. Deri më tani, administrata jonë ka funksionuar e shpërndarë në baraka dhe objekte të tjera të vjetruara. Tashmë jemi vendosur në një objekt të mrekullueshëm, i cili përveç plotësimit të kriterëve dhe kushteve të punës po ofron edhe shërbime më cilësore, efikase dhe transparente për qytetarët.

Në fushën e arsimit, vitin që lamë pas kemi përfunduar dy çerdhe të reja në Sllavi dhe në Gadime, ndërsa ka filluar ndërtimi edhe i dy çerdheve të tjera në Rufe dhe Shalë. Është vendosur gurë themeli i shkollës në Ribar të Madh, janë renovuar disa shkolla në fshatrat tona dhe po vazhdojmë edhe këtë vit. Gjatë këtij viti kemi angazhuar 32 studentë lipjanas për praktikë me pagesë në Komunën e Lipjanit dhe kjo praktikë do të vazhdojë edhe në vitet e tjera. Po ashtu, kemi progres edhe me ndarjen e bursave për student, ku kemi ndarë 175 bursa.

Në vitin 2022 kemi dyfishuar subvencionet në kulturë, rini dhe sport nga 125 mijë euro sa ishte në vitin 2021 kemi ngritur në 250 mijë euro në vitin 2022. Janë subvencionuar gjithsej 19 Klube Sportive si dhe kemi financuar edhe botime të librave si dhe aktivitete të ndryshme kulturore, sportive dhe rinore. Është afër përfundimit palestra sportive në qytetin e Lipjanit dhe së fundmi kemi nisur ndërtimin e sallës së sportit në fshatin Glllogovc.

Në mirëpritje të mërgatës tonë është mbajtur aktiviteti “Mërgata Fest&Sport”, organizimi i tre netëve me muzikë, DJ dhe gara të ndryshme sportive që i dha gjallëri si asnjëherë me parë qytetit të Lipjanit. Po ashtu kemi vazhduar me edicionin e 3 –të të festivalit tradicional për fëmijë “Lipjani Këndon”, një mundësi e mirë që gjeneratat e reja të shpalosin talentet e tyre në fushën e kulturës dhe këndimit. Jane zhvilluar edhe një varg të aktiviteteve tjera kulturore dhe sportive gjatë vitit që lamë pas.

Edhe këtë vit kujdesi ndaj hapësirave publike ka vazhduar në mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen e lumenjve, mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes si dhe mirëmbajtjen e shtatoreve, lapidarëve dhe varrezave. Vetëm në vitin 2022 kemi mbjellur mbi 600 (drunjë) pemë dekorative në qytetin e Lipjanit, edhe në disa vendbanime tjera. Kemi filluar ndërtimin e shtretërve të lumenjëve në lumin Janjevka Lipjan, në Gadime, Smallushe, Glllogovc, Ribar i Madh dhe do të

vazhdojmë edhe vitin e ardhshëm. Kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet në shtigjet e ecjes në Sllovi dhe në Gadime, po vazhdojnë investime shtesë tek shtigjet e ecjes në Lipjan.

Gjithashtu janë ndërtuar këndet e lodrave në fshatrat Sllovi, Gadime dhe në qytetin e Lipjanit dhe është nënshkruar kontrata për investime në rregullimin e lodrave për fëmijë edhe në fshatra të tjera.

Gjatë vitit 2022, kemi ndërtuar kapacitete të plota në QKMF Lipjan për realizimin e pesë analizave laboratorike shtesë si dhe kemi investuar në pajisjet e nevojshme në fushën e stomatologjisë duke i përfshirë edhe qendrat e tjera shëndetësore. Po ashtu, jemi duke vazhduar me renovimin e qendrës shëndetësore në Gadime dhe do të vazhdojmë investime në të gjitha qendrat e shëndetit. QKMF është furnizuar edhe me një autoambulancë për shërbime të pacientëve.

Gjatë kësaj periudhe raportuese një rëndësi e veçantë i është kushtuar funksionalizimit të Zonës Ekonomike në Qylagë, një zonë mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik jo vetëm për komunën e Lipjanit po edhe më gjerë. Rëndësi e veçantë i është kushtuar menaxhimit të pronave komunale dhe tani është ndërtuar standard i mirë i transparencës dhe vendimmarrjes lidhur me pronat komunale.

Kemi vazhduar subvencionimin me sera dhe mekanizëm bujqësorë për ekonomitë familjare, në bashkëpunim edhe me donatorë e partnerë të tjerë vendor dhe ndërkombëtarë.

Gjatë kësaj periudhe ndonëse për shkak të ngritjes së çmimeve punimet kanë stagnuar në disa projekte, në kemi vazhduar me ndërtimin e rrugëve në vendbanimet e ndryshme. Është bërë asfaltimi i rrugës që e lidhe fshatin Hallaq i Madh – Rufe i ri, Ribar i Madh- Ribar i Vogël dhe Poturovc - Dobraj e Madhe si dhe asfaltimi i rrugës rreth shtratit të lumit Janjevka. Gjithashtu janë asfaltuar rrugicat edhe në fshatra tjera dhe do të vazhdojmë edhe këtë vit.

Janë ndërtuar trotuarë dhe është investuar në instalimin e ndriçimit publik në rrugën “Zylfije Gashi” Lipjan si dhe në fshatrat Akllap, Gllavic – Marevc, Mirenë, Teqe etj.

Gjatë vitit 2022 kemi filluar me ndërtimin e planit zhvillimor Komunal, një dokument strategjik që pritet të përfundojë gjatë vitit 2023.

Gjatë vitit që lamë pas janë nënshkruar 37 marrëveshje bashkpunimi me partner vendorë e ndërkombëtarë. Bashkëpunimi me institucione vendore e ndërkombëtare gjithsesi ka shënuar progres në avancimin e shërbimeve dhe investimeve në teren. Sot komuna jonë është partnere në shumë projekte të cilat gjatë vitit 2023 do të implementohen.

I nderuar kryesues,

Të nderuar këshilltar komunal dhe

Ju të dashur qytetarë,

Konsideroj se në aktivitetet tona objektive e përhershme mbetet qeversija e ligjshme, transparente dhe llogaridhënese. Mirëpo çdo herë periudhat raportuese reflektohen edhe me sfida të ndryshme që kemi para vetes.

Besimi i juaj dhe bashkëpunimi me qytetarë për të menaxhuar interesin publik, është motivimi kryesor për të shtuar përkushtim në realizimin e sa më shumë projekteve që komuna e jonë të avancojë çdo ditë ditë e më shumë.

Më lejoni ta mbyll fjalën time duke e ripotencuar edhe në fund, krizën e inflacionit të lartë që po përballemi i gjithë vendi si dhe pasojat e COVID19 të cilat e kanë vështirësuar skajshmërisht jetën e qytetarit.

Të dashur qytetar,

Pavarësisht sfidave dhe vështirësive që patëm Lipjani po rritet, Komuna jonë mbetet komuna me progres të jashtëzakonshëm me trende të rritjes, Lipjani mbetet konkurent i fortë në zhvillimin e përgjithshëm shoqërorë.

Unë zotohem që do të vazhdojë të angazhohem fortë e me përgjegjësi të zhvillojmë vendin tonë, komunën tonë. Mbështetja juaj është determinuese e sukseseve tona.

Imri Ahmeti

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për periudhën janar – dhjetor 2022, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar- Dhjetor 2022, angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disipline në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore ka vazhduar me përcjelljen e zakonshme të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës si dhe harmonizimin e akteve të Komunës me dispozitat e reja ligjore.

Gjatë periodës raportuese kemi dhënë këshilla juridike dhe kemi ndihmuar Drejtoratet dhe sektorët e tjerë të komunës edhe në përpilimin e akteve apo rregullimin e pjesës hyrëse - bazës ligjore sipas kërkesave të tyre si dhe kemi dhënë opinione të ndryshme rreth nënshkrimit të Memorandumeve apo Marrëveshjeve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform legjislacionit në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nënpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët t'i dërgojë në Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit të përpunuesit sipas kompetences.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-dhjetor 2022, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Propozim Rregullore dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-dhjetor 2022:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	490 vendime gjithsej 363 vendime me karakter individual jo të përgjithshëm ndërsa 127 vendime me karakter të përgjithshëm
2.	Shkresat	318
3.	Urdhëresa	3
4.	Kontrata	19
5.	Marrëveshje	442
6.	Propozim - Rregullore dhe Propozim -Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës	52
7.	Komente në Projekt - Ligje	2

Nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për periodën janar – dhjetor 2022, pozicioni buxhetor – subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2022 në pajtim me dispozitat ligjore sipas vendimeve të kryetarit të komunës janë shpenzuar të gjitha mjetet e planifikuara në këtë kategori.

AVOKATJA PUBLIKE KOMUNALE

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit:

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve Avokatja Publike Komonale brenda afatit të kërkuar bën këtë raport të punës me sa vijon:

Lëndë të bartura nga vitet paraprake janë 1428 lëndë, ndërsa të pranuar deri me dt.31.12.2022 janë 327, në procedurë kanë qenë gjithsej 1755 lëndë.

- Në procedurë kanë qenë gjithsej 1755 lëndë
- Të përfunduara gjatë periudhës raportuese janë 124 lëndë

Në procedurën administrative kemi bashkëpunuar me të gjitha drejtoritë komunale për sigurimin e provave materiale për seancat gjyqësore dhe kompletimi i lëndëve por kemi dhënë edhe ndihmë juridike kur kanë kërkuar drejtoritë përkatëse.

Zyrtari i Lartë Ligjor ka marrë pjesë në disa komisione në cilësi të anëtarit, i caktuar me Vendim nga Kryetari i Komunës si punë shtesë jashtë detyrave të përditshme të punës.

Punët dhe aktivitetet e realizuara:

Gjatë kësaj periudhe kemi pasur 411 seanca gjyqësore, kemi ushtruar 194 ankesa, 269 përgjigje në padi në procedurë civile, procedurë përmbartuese kemi ushtruar 19 prapësime dhe 4 ankesa në procedurë përmbartimore.

Si palë e dëmtuar kemi marrë pjesë në seancat gjyqësore në procedurë penale duke propozuar që kërkesa pasurore juridike të realizohet gjatë të njëjtës procedurë për dëmin e shkaktuar për secilën lëndë.

Statistikat:

Nr.	Llojet e procedurave	Lëndë të bartura	Lëndë të Pranuara	Nr. i përgjithshëm i lëndëve	Lëndë në Gj.Th.P-Dega në Lipjan –P.Privat	Lëndë në Gjykatë Apelit	Lëndë në Gjykatën Supreme	Lëndë në Pcedurë Administrative	Lëndë të Kryera	Lëndë në Procedurë
1.	Procedurë penale	11	0	11	/	/	/	/	0	11
2.	Procedurë civile	1249	269	1518	1285	194	3	/	86	1432
3.	Procedurë përmbartuese	139	58	197	193	4	/	/	46	147
4.	Procedurë administrative	29	3	32	/	/	/	/	32	0
5.	Gjithsej	1428	330	1755	1478	198	3	/	164	1591

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kanë vazhduar në procedurë civile për lëndët e ish „Kosovatransit“ janë 10 lëndë që kërkojnë kompensimin e të ardhurave personale prej vitit 1990 deri 1999 duke u bazuar në Aktin për pranim dorëzim të ish „Kosovatransit“ në mes të AKP-së dhe Komunës së Lipjanit të nënshkruar në vitin 2012 dhe shuma e kërkuar për të gjitha lëndët është 113,335.43 €, e krejt kjo është si pasojë e pranimin të NP „Kosovatrans“ në Lipjan sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike dhe aktin të cekur më lart, lidhur me këtë çështje në procedurë është edhe një lëndë me numër të përgjithshëm të punëtorëve prej 83 punëtorë të cilët kërkojnë kthim në punë dhe kompensim të ardhurave personale nga viti 1990 deri 1999.

Në konteste civile janë 1387 lëndë prej tyre janë fituara 34 lëndë, 3 lëndë janë kontest pune në shumën e përgjithshme mbi 59.000.00€, 4 janë në pronësi, një „Kosovatrans” për kompensimin e pagave nga viti 1992 deri 1999 në vlerë prej 16.968.00 €, të tjerat janë kompensime dëmi në shumën e përafërt prej 85.000.00 €.

Në procedurë përmbarese deri me 31 Dhjetor 2022 janë gjithsej 197 lëndë prej tyre janë ekzekutuara 46 lëndë, ndërsa të pa ekzekutuar janë 151 lëndë dhe borxhi i mbetur i Komunës-debitorit deri në këtë fazë mund të jetë mbi **300,000.00 € + kamata dhe shpenzimet e procedurës** i cili borxh është i punëtorëve të arsimit – DKA, punëtorëve të shëndetësisë, shpronësimit dhe Operatorë Ekonomik.

Në procedurë penale i kemi dërguar mbi 80 aktgjykime MBZHR - Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe tani ky agjencion është duke ekzekutuar këto lëndë me përmbareues privat por ende nuk kemi informatë se a janë përfunduar apo janë ende në procedurë.

Çështje tjetër që ende ka mbetur të rregullohet është edhe çështja e zjarrfikësve në mes të Komunës dhe MPB-Agjencinë e Emergjencës së Kosovës nga se është i pa definuar mirë statusi i tyre se punëtorë të kujt janë, ndërsa Komuna pritet që për secilin punëtorë – zjarrfikës ti paguan përafërsisht nga 5,000 € për punën gjatë festave, ndërrimin e natës, fundjavës dhe shtesat tjera që po i kërkojnë shpenzimet e udhëtimit dhe shujtën.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Spektori për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2022 është angazhuar maksimalisht në realizimin e detyrave dhe përmbushjen e obligimeve në mënyrë që Komuna e Lipjanit të vazhdojë të jetë në mesin e komunave të para sa i përket transparencës dhe llogaridhënies.

Në web faqen zyrtare të Komunës ka vazhduar publikimi i materialeve të ndryshme në mënyrë që qytetarëve tu ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo web faqe ka qenë edhe një udhëzim shtesë dhe transparent në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontrata, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve si dhe shumë materiale të tjera.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti me një transparencë të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar drejtpërdrejtë në kanalin zyrtarë të komunës në Youtube.

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2022, Spektori për Marrëdhënie me Publikun ka kryer punët si në vijim:

Është bërë përcjellja e aktiviteteve të kryetarit të komunës, aktiviteteve të tjera komunale brenda dhe jashtë komunës dhe pastaj përgatitja e lajmeve për publikim në web faqen zyrtare, rrjetet sociale si dhe në media të ndryshme;

Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve të tjerë janë publikuar materialet e ofruara për zyrën e informimit;

Janë publikuar në web faqe të gjitha vendimet e kryetarit, gjitha vendimet dhe rregulloret nga sektori i Kuvendit në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Po ashtu janë publikuar në web faqe raporte, vendime, njoftime dhe konkurse të shumta të cilat janë ofruar në zyrën për informim. Konkursat me kërkesën e përgjegjësve janë publikuar në gazetën ditore.

Gjithashtu është bërë publikimi i materialeve të ndryshme të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoria i Prokurimit.

Në vitin 2022 janë vizituar të gjitha projektet që janë implementuar në terren dhe janë bërë fotografi për nevoja të zyrës si dhe të njëjtat janë arkivuar, ku po ashtu janë vizituar shumica punëve që janë bërë dhe janë duke u bërë në teren duke marrë pamje me kamerë për nevojat e zyrës për informim. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike. Është bërë përgatitja e reportazhit për vitin 2022 si dhe menaxhimi i paneleve në hyrje e dalje të qytetit të Lipjanit, menaxhimi i kontratave për shërbime mediale, publikime në gazeta ditore (njoftime, vendime dhe shprehje të interesit), si dhe punë të tjera që dalin në kuadër të zyrës për informim.

STATISTIKAT

Nr.	Emërtimi	Publikimet
1.	Reportazhi vjetor	1
2.	Lajme ne web	Mbi 300
3.	Marrëveshje	36
4.	Vendimet e kryetarit	Të gjitha vendimet me karakter të përgjithshëm
5.	Raportet e kryetarit	2
6.	Qasje në dokumente publike	30
7.	Raporti i auditorit	1
8.	Raporte për diskutime publike	12
9.	Procesverbalet e konsultimeve	11
10.	Deklarimi i pasurisë	2021 dhe 2022
11.	Raporte të drejtorateve	Mbi 100
12.	Kontrata te prokurimit	109
13.	Dokumente te ndryshme nga drejtorati i prokurimit	664
14.	Vendime te OSHP-se	14
15.	Konkurse	88
16.	Njoftime	198
17.	Raporte dhe dokumente nga Drejtorati për Buxhet dhe Financa	38
18.	Thirrjet dhe Ekstraktet e KKSBB-se	11
19.	Plane komunale	6
20.	Strategji	1
21.	Vendimet e kuvendit	67
22.	Rregullore	2
23.	Materialet e kuvendit	Për të gjitha seancat e mbajtura gjatë vitit 2022
24.	Procesverbale dhe ftesa nga sektori i kuvendit	69

TAKIME E NDRYSHME

Kemi pasur takime të shumta me gazetarë nga mediat e ndryshme të shkruara dhe elektronike. Takime janë zhvilluar edhe me përfaqësues të organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë punën e Komunës së Lipjanit. Vitin 2022 takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyrës sonë për informata rreth komunës. Po ashtu gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe trajnime dhe takime të tjera të organizuara me zyrtarët për informim, ku kemi marrë pjesë edhe ne.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës, ishte përpiluar edhe Plani Strategjik Trevjeçar 2021-2023 në të cilin janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të Auditimit për të gjitha fushat e Auditimit. Andaj, pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar, është bërë rangimi i detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Plani strategjik për vitet 2022-2024, dhe plani vjetor i punës për vitin 2022, pas përpilimit nga udhëheqësi i NJAB-së janë prezantuar për shqyrtim në Komitetin e Auditimit dhe pas miratimit të tyre janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe janë dërguar edhe në NJQHAB.

Në përputhje me Planin Strategjik për vitet 2022-2024, është hartuar edhe plani vjetor i punës për vitin 2022.

Angazhimi i NJAB në vitin 2022, ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2022 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera, pas pranimi të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i

dërgon me Raportin Final, ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001, me të cilën ka njoftuar edhe ZKA – në lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB. Puna që është kryer gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, i referohet pikërisht përbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2022, kishte planifikuar Auditime të rregullta, 11 detyra për dhënie të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore Komuna e Lipjanit.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2022 NJA ,ka Finalizuar 11 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

- Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2021 Fushëveprimi: 01.01.2021 - 31.12.2021.
- Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë: Janar 2021 – Janar 2022
- Të Hyrat nga Qiratë Komunale, të hyrat nga hapësirat publike dhe tregjet komunale: 01.01.2020 deri më 28.02.2022
- Auditimi i Procedurave të Shpenzimeve në QKMF, Drejtoria e Shëndetësisë: 01.05.2020 – 30.04.2022
- Auditimi "Përdorimi dhe Menaxhimi i veturave zyrtare në Administratën Komunale": 01.05.2020 deri më 30.04.2022
- Auditimi i procesit të Hyrave në drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm: 01.04.2021 - 31.05.2022
- Auditimi i të hyrave nga dokumentet e lëshuara të shërbimit civil në ofiqari dhe zyrët e vendit –Drejtoria e Administratës.
- Auditimi i procedurave për menaxhimin e kontratave me rastin e implementimit të projekteve, në Drejtorinë për Infrastrukturë Publike, fushëveprimi: Qershor 2021 - Muajin Qershor 2022.
- Auditimi i të hyrave në Shkollën e Mesme Profesionale dhe Çerdhen e Fëmijëve në Lipjan – DKA –fushëveprimi Shator 2019 – Qershor 2022
- Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale (13 programet buxhetore) fushëveprimi: 01.10.2020. - 30.09.2021
- Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale: për periudhën 01.11.2020. -30.10.2021
- Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, NJAB ka monitoruar edhe shkallën e implementimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entiteteve ku është kryer auditimi), ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së.

Në këtë periudhë janë kryer edhe 7 Rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim. Të gjitha raportet finale janë dorëzuar për përgjegjësitë e entiteteve të audituara dhe Zyrës së Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit.

NJAB gjatë vitit 2022, ka kryer edhe rishikimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i jashtëm për raportin e PVF për vitin 2021, dhe këtë rishikim e ka prezantuar në Asamblenë Komunale.

NJAB në fund të vitit 2022 u ka dërguar planet e zbatimit të gjitha entiteteve të audituara për të marrë informata lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB, gjatë vitit 2022 me qëllim të prezantimit sa më të saktë të shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga NJAB në Raportin vjetor i cili dërgohet në NJQHAB .

STATISTIKAT

Për vitin 2022, NJAB ka kryer 11 Auditime të rregullta të planifikuara të cilat ishin paraparë me planin vjetor të punës për vitin 2022 dhe 7 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve.

Është mbajtur një trajnim me NJQHAB – it me temën Auditimet e performances, si dhe takimi lidhur me prezantimin e përbushjes së kriterëve për performancë nga lëmia e financave, prokurimit, burimeve njerëzore dhe auditimit të brendshëm me DEMOSIN.

TAKIMET E NDRYSHME

Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

Takimi i parë është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2022, për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2021,

Takimi i dytë për raportin për Tremujorin e parë 2022, (TM1-2022), takimi është mbajtur në Muajin Prill- 2022.

Takimi i tretë me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë (TM2-2022) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Korrik 2022.

Takimi i katërt me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë (TM3-2022) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2022.

Takimi i pestë me Komitetin e Auditimit për aprovimin e planit strategjik të NJAB-së për vitet 2023-2025 dhe planit vjetor punës për vitin 2023 është mbajtur në fund të Muajit Dhjetor 2022, ku është miratuar plani i punës për NJAB-në nga Komiteti i Auditimit dhe është aprovuar nga Kryetari i Komunës.

SEKTORI I PERSONELIT

PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit, sektori për personel është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimin e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të Sektorit për Personel, vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit, Rregullimin dhe digjitalizimin e dosjeve të stafit dhe futjen në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe në dosje personale, të tjera ndryshimet, transferimet, pagesat retroaktive, largimet bëhen nga Zyra e Personelit për Sistem të Pagave si dhe (kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime etj. Në Administratën Komunal sipas Strukturës Organizative të Administratës Komunale kemi 231 pozita të planifikuara ku aktual kemi 207 zyrtarë, prej tyre meshkuj kemi 134, ndërsa femra 64.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Sektorit për Personel ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike si dhe raportimin pranë MPB/MAP – it për përqindjen e vlerësimit, përgatitja e planit të trajnimit për vlerësimin e nevojave për ngritje të kapaciteteve dhe koordinimin e trajnimeve të stafit duke ju drejtuar me një kërkesë të tillë MPB/MAP – it , punimi i vendimeve të ndryshme sipas kërkesave të palëve dhe zyrtarëve të administratës komunale kërkesa të ndryshme individuale të stafit: pushime, vërtetime etj si dhe përgatitja e formularëve për ndryshime, transferimet, pagesat retroaktive për Sistem të Pagave.

STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporti një vjetor- dhe mujore janar – dhjetor	12
2	Tabela informuese përAntikorrupsion	1
3	Pushime mjekësore.	101
4	Pushime vjetore.	172
5	Vendim për pushim përdëllimi	2
6	Pushime mjekësore Covid-19	4
7	Punimi i listës për dëshmi të vaksinimit Covid-19	1
8	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	426
9	Punimi i listave për ardhje-shkuarje për Kulturë, Rini dhe Sport	6
10	Punimi i listave për ardhje dhe shkuarje për praktikant	192
11	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	1

12	Regjistrimi i kërkesave për praktikantë me pagesë	32
13	Regjistrimi dhe bartja e regjistratorëve në arkivën e Komunës	80
14	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	30
15	Punimi i formularëve për ndryshime	33
16	Pëlqim për transferim të përkohshëm për vendin e punës	1
17	Raporti i listave ardhje dhe shkuarje për punëtorët	156
18	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar	17
19	Punimi i formularëve për punëtore të rinj	25
20	Punimi i formularëve për transferim bankar	11
21	Punimi i formularëve për retroaktiv	18
22	Punimi i planit të punës dhe vlerësimi zyrtarëve komunal në SIMBNJ	13
23	Punimi i formularit me te dhënat për zyrtaret publik për MBPB	2
24	Përgjigje në Ankesë	16
25	Përgatitja e Kontratave për Praktikantë	32
26	Vërtetim për kryerjen e praktikës	6
27	Vërtetim për përvojë të punës	67
28	Vendime për kryerjen e praktikës	7
29	Vendim për Transferime	24
30	Pëlqim për Transferime	14
31	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	220
32	Shkresa të ndryshme zyrtare përmes email-ve zyrtare	138
33	Vendim për Pushim të Lehonisë	2
34	Vendim për pushim ditorë për nënat lehonë për mbrojtjen e të Ushqyerit të fëmijës	3
35	Vendime për përfundimin e marrëdhënies së punës me arritjen e moshës së pensionimit	8
36	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me dorëheqje	2
37	Vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me rastin e vdekjes së zyrtarit.	2
38	Punimi i përshkrimit të detyrave të punës	20
39	Vendim për pagesa jubilarë	1
40	Vendim për emërim	8
41	Kompletimi i dosjeve me te dhëna personale sipas ligjit të ri	47
42	Vendim për pagë shtesë me rastin e pensionimit	2
43	Vendimin për lirim nga detyra	3
44	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	7
45	Njoftim për përfundimin e procedurës brenda kategorisë në ZLK	6
46	Njoftim për Komisionin Disiplinor	1
47	Ftesë për Komision Disiplinorë	2
48	Vendim për anulim të konkurseve të brendshme	5
49	Publikimi i konkurseve për lëvizje paralele në shërbimin civil	22
50	Publikimi i konkurseve për ngritje në detyrë (avancim) në shërbimin civil	4
51	Publikimi i konkurseve për pranim në shërbimin civil	19
52	Publikimi i konkurseve për Arsim	21
53	Publikimi i konkurseve për Shëndetësi	9
54	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve	394
55	Vendim për refuzim të Aplikacioneve	121
56	Përgjigje në ankesat e procedurave të rekrutimit	30
57	Formimi i Komisionit Rekrutues për lëvizje brenda kategorisë dhe ngritje në detyrë (avancim)	8
58	Formimi i Komisionit Rekrutues për pranim në shërbimin civil	15
59	Kërkesa për aprovim të publikimit të konkurseve	45
60	Njoftime për përfundimin e verifikimit paraprak	45
61	Njoftime për përfundimin e procedurës së rekrutimit	46
62	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	2
63	Përgjigje në kërkesë që nuk keni masa disiplinore	1

64	Njoftim për kryetarin për ekspert të jashtëm	1
65	Vendim për emërim të ekspertit të jashtëm	1
66	Kontratë Pune për Ekspert të jashtëm	1
67	Njoftim për Covid - 19	1
68	Njoftim për mbajtje të test me shkrim	19
69	Njoftim për mbajtje të intervistës me gojë	25
70	Kërkesë për Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/ DMZP	2
71	Kërkesë për mjete buxhetore për sistem të pagave për pagesë retroaktive	15
72	Punimi i regjistrit për paga jubilarë për zyrtarët e administratës Komunale	1
73	Punimi i Planit të Personelit për Administratën Komunale, Arsimit dhe Shëndetësi	3
74	Kërkesa të ndryshme	11
75	Përgjigjeje në Kërkesat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	36
76	Përgjigjeje në kërkesat e Avokatës Komunale	18
77	Përgjigjeje në Kërkesë DSHPS	2
78	Përgjigjeje në kërkesat e zyrtarëve të Administratës Komunale	79
79	Përgjigjeje në shkresa për masa disiplinore	2
80	Vendime për punë shtesë	1
81	Vendim për pushim pa pagesë	1
82	Vendim për pagesë shtesë	9
83	Vendim për kthim në vendin e punës	3
84	Vendim për shfuqizim	2
85	Vendim për pushim të përdëllimit	2
86	Vendim me dorëheqje nga puna	1
87	Vendim për zëvendësimin e ekspertit të jashtëm	1
88	Vendim për pushim të lehonisë	2
89	Vendim për pushim me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë	2
90	Vendime për Udhëtime Zyrtare	6
91	Vendime për refuzim pas testim me shkrim	1
92	Pëlqime për emërim në vendin e punës	20
93	Pëlqime për vendin e punës së punëtorëve	8
94	Punim i formularit për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë 1 deri 31 mars 2021 në formular Excel	1
95	Shkresë njoftim për mbarim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
96	Shkresë njoftim për emërim të funksionit të anëtarit të asamblesë së Kuvendit Komunal	1
97	Pushim Martesor	2
98	Ftesa dy për Komisionin Disiplinor	2
99	Vendim për statusin e nëpunësve civil	100
100	Shkresa lidhur me njoftimin e zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë së rregullt muajin mars	46
101	Vendime për punë shtesë	3
102	Përgjigjeje në kërkesë	9
103	Përgjigjeje në shkresa të ndryshme zyrtare	4
104	Pushim i Atësisë	1
105	Kërkesë për Komision Disiplinor	3
106	Vendim për Autorizim	2
107	Kompletimi i lëndëve për Auditor të Brendshëm	32
108	Sistemi i të dhënave Personale të zyrtarëve të Administratës Komunale në SIMBNJ	14
109	Regjistri për dosjet personale	33
110	Regjistri për auditorët e jashtëm	1
111	Njoftim për vlerësim të punëtorëve për vitin 2022	15
112	Plani i trajnimeve	1
113	Aktemërim	18
114	Aktemërim me ristrukturim të zyrtarëve	9
115	Gjithsej	3344

TAKIME TË NDRYSHME

Spektori për Personel ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgaditur një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese të vitit 2022 janë përgatitur Vendime, Shkresa të ndryshme, Pëlqime, Kontrata, Marrëveshje Bashkëpunimi dhe Propozim – Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2022:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	16
2.	Shkresa	154
3.	Pëlqime	1
4.	Kontrata	2
5.	Propozim-Vendime	8
6.	Marrëveshje Bashkëpunimi	1

Spektori Pronësoro – Juridik ka pranuar lëndë nga Drejtorati i Administratës Komunale, Sektor të Komunës si dhe lëndë të parashtruar nga palët, në procedurë administrative kemi pranuar gjithsej 197 lëndë, prej tyre të kryera 182 dhe në procedurë 15 lëndë.

TAKIMET E NDRYSHME

Spektori Pronësoro-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Gjatë kësaj periudhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ka qenë e angazhuar rreth problemeve të personave të riatdhesuar, puna me institucionet qendrore dhe me organizatat joqeveritare.

Aktivitetet me të cilat është marrë ZKKK-ja në këtë periudhë.

ZKKK ka qenë pjesë e takimeve të ndryshme të organizuara nga Zyra e Kryeministrit, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim si dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme

Gjithashtu kemi realizuar edhe vizita tek familjet skamnore dhe të riatdhesuara, pjesëmarrje në komitete, komisione, tryeza e debate publike.

Është përgatitur drafti i Planit të Veprimit për Kthim të Qëndrueshëm 2022-2025, i cili ka qenë objekt konsultimi publik dhe për të cilin është mbajtur debat publik. Plani i veprimit për kthim dhe zgjidhje të përhershme për periudhën 2022-2025 është miratuar në Kuvendin e Komunës së Lipjanit.

Koordinatori i ZKKK-së mori pjesë në një takim të organizuar nga zyra e Kryeministrit lidhur me bashkëpunimin dhe problematikat e zyrës. Është mbajtur një takim me përfaqësues të FSK-së lidhur me konkursin për kadetë.

Vizituam shtëpitë në Medvec që janë ndërtuar për familjet e riatdhesuara dhe në të cilat askush nuk jeton prej kohësh. Zyrtarët e ZKKK-së bënë një raport për gjendjen e shtëpive të ndërtuara nga MPB-ja për familjet e riatdhesuara në pronat komunale në Medvec.

Në bashkëpunim me Nënkryetarin për Komunitete dhe Qendrën për Punë Sociale, janë shpërndarë 150 pako me mish për familjet në nevojë në komunën e Lipjanit.

Janë pranuar dhe janë miratuar 13 kërkesa për ndihmë financiare të njëherëshme.

Kemi marrë pjesë në punën e KKS-së dhe Komitetin për Komunitete, ku raportojmë për punën e ZKKK-së dhe këshillit komunal për persona me aftësi të kufizuara.

Është vizituar shkolla "Braća Aksić" në Lipjan dhe është mbajtur takim me drejtorin e shkollës lidhur me nevojat dhe problemet në shkollë si dhe përmirësimin e bashkëpunimit të ndërsjellë. Për nevojat e shkollës fillore "Braća Aksić" në Lipjan, janë dorëzuar derivatet për ngrohje dhe furnizimet e zyrës nga Drejtoria e Arsimit.

ZKKK-ja ka shpërndarë 300 kosha plehrash për komunitetin rom dhe ashkali në komunën e Lipjanit, të cilat janë siguruar nga VoRAE.

Në bashkëpunim me MPB-në dhe Zyrën e Punësimit kemi vizituar 2 fitues të planit të biznesit dhe 1 familje të riatdhesuar.

Zyrtarët janë emëruar të punojnë në bazën e të dhënave të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. U mbajt një takim me Advancing Together lidhur me informacionin për familjet e kthyer dhe pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave fillore të komunitetit serb.

Për periudhën e vitit 2022 janë riatdhesuar 4 familje, 2 prej të cilave kanë aplikuar në zyrë por nuk kanë plotësuar kriteret për dhënien e ndihmës, ndërsa nuk ka pasur kërkesa për kthim.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në Drejtorinë për Administratë janë realizuar detyra dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, statutit të Komunës së Lipjanit, ligjet tjera, Udhëzimet, Urdhëresat, si dhe Rregulloret tjera Komunale.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Përgjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me menaxherët kemi bërë evidentimin e kontratave që skadojnë përgjatë këtij viti, e që janë të ndërlidhura me Administratën si dhe i kemi proceduar tutje për Planifikim të Prokurimit për vitin vijues, si dhe janë bërë planifikime shtesë të nevojshme për Drejtoratin e Administratës.

SEKTORI PËR ADMINISTRATË TË PËRGJITHSHME

Në sektorin për Administratë të Përgjithshme, në qendrën për shërbim me qytetarë gjatë vitit ka pasur rritje të numrit të kërkesave në shërbimet me qytetarë, konkurs për praktikant si dhe konkurse në drejtoratin e arsimit, kurse konkurset për rekrutim në shërbimin civil aplikimi ishte në mënyrë elektronike.

Në këtë periudhë të gjitha shërbimet janë kryer në mënyrë efikase dhe me korrektësi që janë ofruar drejtpërdrejtë me qytetarë, si në regjistrimin e të gjitha shkresave të adresuar nga personat fizik dhe juridik në sistemin e intranetit.

Po ashtu, janë bërë disa ndryshime teknike në intranet, në regjistrimin dhe bashkëngjitjen e lëndës.

Të gjitha shkresat të adresuara nga arkiva e MAPL – së për komunën e Lipjanit janë regjistruar dhe protokolluar në sistem të intranetit, shkresa, konfirmime ligjore, njoftime etj.

Punëtori të organizuara nga Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale (KLGI), në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) me temë "Praktikat e digjitalizimit dhe inovacionit në nivel lokal".

Takim me Asociacioni e Komunave të Kosovës, në kuadër të koordinimit të objektivave dhe aktiviteteve të radhës të Kolegjiut të Drejtorëve Komunal për Administratë Komunale, në diskutimin e temave dhe shqetësimeve të adresuara nga autoritetet lokale, në kuadër të zhvillimit të veprimtarisë të Kolegjiut për fushën e administrimit lokal.

Gjithashtu, është mbajtur një takim nga kolegjiut për administratë lokale, ku qëllimi i këtij takimit ka qenë formimi dhe funksionimi i kolegjiut për të ndihmuar në analizimin e çështjeve të pushtetit lokal, me qëllimin e përmirësimit të shërbimeve komunale.

STATISTIKAT:

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
➤	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera të personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	12474
2	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	593
3	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	40528
➤	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postës së institucionit.	
4	Aktvendime të Shpërndara	433
5	Ftesa të Shpërndara	1129
6	Vendime të Shpërndara	590
7	Fletëparaqitje për Gjykatë	100
8	Njoftime të Shpërndara	661
9	Të Arritura me Postë	576

10	Të Dërguara me Postë	1815
11	Fatura tatimore të Qirasë	143
➤	Zyrtari i Pranimit/Logjistikës	
13	Futja e të dhënave në SIMFK – Freebalanc	2100
14	Komentet në raportin e pranimit të mallit me modul të blerjes.	2100
15	Pranimin e mallit të cilën është porositur malli nga furnitorët ekonomik.	721
16	Përgatitja e formularëve të shënimeve për mallrat e pranuar me anë të kërkesës interne nga organet përkatëse të cilët kanë kërkuar furnizim të mallit.	721
17	Përgatitja e formularëve për mallin e pranuar me anë të fletë dërgesës nga operatorët ekonomik, hyrje – dalje	721
18	Regjistrimi i faturave në librin e fatuarave hyrës	729
19	Shpërndarja e mallit të pranuar nga operatorët ekonomik.	721
20	Regjistrimi i Faturave të Op. Ek. Hyrje – Dalje për inventarizimin dhe paisjeve të IT në programin E-Qeverisja	333
21	Stoqe të grumbulluar me material në depon e komunës	53
22	Gjithsej	67241

SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

Në sektorin e Gjendjes Civile, të gjitha shërbimet janë realizuar në mënyrë transparente, dhe me korrektësi me shërbime të shpejta të cilat janë dhënë për qytetarët.

Respektivisht në udhëzim administrativ (MPB) Nr.01/2022 për dokumentet e gjendjes civile, për përdorim brenda vendit lëshohen në letër të bardhë standarde të formatit A4, ndërsa dokumentet e Gjendjes Civile për përdorim jashtë vendit lëshohen në letër të veçantë sipas specifikave të përcaktuara nga Agjencia e Regjistrimit Civil, ashtu siç janë lëshuar deri më tani.

Po ashtu, edhe ndryshimi i procesverbalit i pranimit të atësisë/amësisë nuk është më dokument i Gjendjes Civile, i cili duhet ti lëshohet qytetarit, ky dokument përdoret për procedurat e brendshme të Gjendjes Civile, dokument i cili mbahet në dosjen e qytetarit, si dhe Dëshmia e Vdekjes më nuk lëshohet nën mbikëqyrjen apo autoritetin e Agjencisë së Regjistrimit Civil, respektivisht të Drejtoratit të Gjendjes Civile, ky dokument tani e tutje lëshohet në një formular me logon e Komunës tonë.

Në platformën E – Kosova është lansuar sistemi i shërbimeve, ku çdo qytetarë i regjistruar mund të paiset me dokumente të gjendjes civile të cilat janë në E-Kosova.

Si prioritet i punës kanë qenë shërbimet e kërkuar nga mërgimtarët.

STATISTIKAT:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	30214
2	Certifikatë e martesës	8801
3	Certifikatë vdekje	2419
4	Certifikatë Vendbanimi	2473
5	Vërtetim nga arkiva	748
6	Certifikatë Shtetësie	596
7	Certifikatë e Statusit martesor	1826
8	Certifikatë të lindjes	18463
9	Certifikatë e Bashkësisë familjare	8466
10	Regjistrimit e reja në LAL	109
11	Regjistrimet e mëvonshme në LAL	164
12	Regjistrimet e reja në LAM	705
13	Regjistrimet e më vonshme në LAM	635
14	Regjistrimet e reja në LAV	185
15	Regjistrimet e më vonshme në LAV	117
16	Aktvendime nga lëmin e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	72
17	Gjithsejtë	75993

SEKTORI I KUVENDIT

Në sektorin për punë të kuvendit dhe komiteteve janë realizuar të gjitha punët në kuadër të planit dhe përgjegjësi. Për mbledhjet e Kuvendit është dërguar materiali në mënyrë elektronike Kryetarit, nënkryetarëve, drejtorëve, anëtarëve të kuvendit, zyrës së informimit, në ministrin përkatëse si dhe si përgatitja e vendimeve e rregulloreve të aprovuara etj. Aktet juridike nënligjore të aprovuara në Kuvend fillimisht, janë dërguar në Ministrin përkatëse për të vlerësuar ligjshmërinë e tyre mandej në publikim në ueb faqe të komunës, kështu me radhë për t' krijuar plotfuqishmëri dhe zbatues të tyre.

Përveç kësaj, janë përkthyer dhe lekturuar materialet për mbajtjen e mbledhjeve, planeve dhe strategji të aprovuara në Kuvend, si dhe shumë materiale tjera të ndryshme.

Përmbledhje e shkurtër e punëve që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve si vijon, është përgatitur materiali në mënyrë fizike, janë mbajtur procesverbale dhe janë hartuar ekstraktet si dhe punë të ngjashme si përgatitja e vendimeve e rregulloreve të aprovuara etj.

Janë mbajtur 12 mbledhje të Kuvendit të Komunës, 11 mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa, 10 mbledhje të Komitetit për Komunitete, 6 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe disa mbledhje të Komitetit për Arsim, Komitetit për shëndetësi, Komitetit për Kulturë Rini e Sport.

STATISTIKAT:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	12	186 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	12	161 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	70	202 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	33	99 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	100	219 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	202	446 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	115	213 faqe
8.	Fotokopjimi	485	55000 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	11	80 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	11	63 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	36	199 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS	6	37 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	77	780 faqe
14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteteve e të ngjajshme).	113	174 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për ueb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	350	1580 faqe
16	Rregullore,Plan, Korniza e të ngjajëshme-Strategji dhe plan	8(3Rreg.+5 plane)	189 faqe
17	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	401	618 faqe
19.	Gjithsejtë	2042	60246 faqe
20.			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 219 orë përkthim gojor

SEKTORIN PËR MIRËMBAJTJE DHE OPERIM

Në sektorin për mirëmbajtje dhe operim të gjitha punët janë kryer në mënyrën më të mirë në këtë sektor, deri të mirëmbajtja dhe sigurimi i veturave dhe gjendjen e tyre e vazhdueshme teknike, si dhe kontrollimi i karburanteve të shpenzuara.

Të gjitha veturat janë të pajisura me pjesë kontrolluese GPS.

STATISTIKAT

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT NUK UDHËHEQET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator dhe mesatarja e harxhimeve.	7	655.52 LITRA
2	Furnizimi me lëndëdjegëse /naftë/ për ngrohjeqendrore	4	8500 LITRA
3	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	217	16203.96 Litra karburante
4	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve.	217	194423 km mes; 8.33 lit/100 km
5	Harxhimet e ujit të pijshëm	/	
6	Furnizim me material teknik për mirëmbajtje të objekteve	/	
7	Furnizim me materialhigjenik	/	
8	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	16	
9	Rregullimi dhe deblokomi i ujit nënyjësanitare	15	
10	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	/	3200 m ²
11	Mirëmbajtja e parkut - kositja e barit,		
12	Servisimi i automjeteve	12	
13	Servisimi i gjeneratorëve	/	
14	Servisimi i kalldatorëve	/	
15	Servisimi i centralit kundër zjarri (Alarmi)		
16	Servisimi i aparateve kundër zjarri		
17	Bartja e zyrtarëve komunal ne trajnime-Prishtine me Kombi	536	
18	Vazhdimi i regjistrimit të autojemjeteve	14	
19	Mirëmbajtja e teknologjisë kompjuterike		
20	Vendosje e pompave zhytëse në pishinë		2 pompa
21	Kërkesa për vetura zyrtare	2087	
	Gjithsejtë	3125	

NJËSIA PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZI GJINORE:

Njësia për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore kanë realizuar disa aktivitete:

Motivimi i gruas në një takim në sallën e kuvendit për regjistrimin e pronës ne emër te dy bashkëshortëve, Tryeza te rrumbullakëta për motivimin e grave në zonat rurale për të zhvillua biznes te ndryshme, duke ofruar një ngritje vetëdijes së grave rurale dhe përfaqësuese në projekte të ndryshme. Përfaqësimit dhe të drejtave të barazisë gjinore në interes të përgjithshëm.

Me rastin e shënimit të 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në përputhje me mandatin dhe traditën shumëvjeçare për shënimin e kësaj dite. Agjencia për Barazi Gjinore ka mbajtur takim me temë “Zhbëjmë paragjykimet punojmë për gjithëpërfshirës”.

Është prezantua në Sesionin informues për grandet "Grante për Gratë në Biznes", në komunën tonë që u mbajt në sallën e Kuvendit Komunal. Të drejtë aplikimi kanë pasur gratë nga mosha 18 deri në moshën 65 vjeçare, të cilat janë të interesuara për të krijuar bizneset e tyre në Komunën e Lipjanit.

Po ashtu, është mbajtur edhe një diskutimi Tryezë e rrumbullakët, gjinia dhe qasja në kujdesin Shëndetësor i organizuar nga AQH.

Gjithashtu, Zyra për Barazi Gjinore së bashku me grupin e grave në Lipjan, në mbështetje të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) Misioni në Kosovë, ka organizuar debat me zyrtarët komunal te pushtetit lokal, me asamblistë si dhe përfaqësues të komuniteteve jo shumicë.

Qëllimi i takimi ishte avancimi, promovimi dhe motivimi i grave për pjesëmarrje dhe për tu zgjedhur në këshillat lokal të fshatrave dhe lagjeve urbane.

Punëtori për Strategjinë dhe Planit të Veprimit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje për komunën e Lipjanit, 2022-2025. Është prezantuar në hapjen ekspozitës e cila është mbajtur me 24 Maj nga nxënësit e Sh.F.M.U “Shtjefën Gjeçovi në Janjevë në kuadër të projektit “Gratë dhe të Rinjtë të bashkuar për zhvillimin e komunitetit dhe trashëgimia kulturore” implementuar nga organizata The IdeasPartnership.

Është mbajtur edhe konferenca përmbyllëse e Projektit me titull “Sigurimi i të Drejtave Pronësore të Grave përmes rritjes së Kapaciteteve Institucionale në Kosovë”, të realizuar nga OJQ “Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi – INJECT”.

Takimin i Platformës- Edukim për të gjithë - Përmbyllja e të Drejtave të Fëmijëve dhe Adoleshentëve me Nevoja të Veçanta dhe nga Komunitetet e cënueshme, ky pilot Projekt është duke u realizua ne shfm “Shtjefan Gjeçovi” në Janjevë Tryezë e përbashkët e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit me temën “Sfidat në zbatimin e ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, me ç ‘rast u prezantua përmbledhja e Raportit drejtuar autoriteteve përgjegjëse gjatë vitit 2021.

Funksionimi i Mekanizmit institucional komunal në shërbim te viktimave në baza gjinore.

Në bibliotekën e qytetit në Lipjan, Njësia për të Drejtat e Njeriut Barazi Gjinore ka organizuar takim së bashku me OJQ-të Handikos dhe Organizata Multi Etnike e Personave me Aftësi të Kufizuara (OMPAK) me qëllim të ngritjes së vetëdijes tek personat me aftësi të kufizuara që të japin kontributin e vetë dhe integrimi i tyre në institucionet komunale.

Aktiviteti i radhës për ndërgjegjësimin e sëmundjes së kancerit të gjirit është mbajtur,në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, aktiviteti sensibilizues i radhës për ndërgjegjësimin e sëmundjes së kancerit të gjirit por edhe për përkrahjen e personave të prekur nga kjo sëmundje.

Takimi joformal i grave dhe përfaqësueseve të institucioneve në Komunën e Lipjanit i organizuar nga Qendra Kosovare për studimet Sigurisë. Ky aktivitet përkrahet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim (SDS) etj.

Po ashtu, është mbajtur mbledhja e parë e Këshilli Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara në Lipjan.

Në kuadër të “16 Ditët e Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore”, Komuna e Lipjanit ka organizuar një numër të madh të akiviteteve, duke përfshirë edhe marshin me moton “Stop këtij fenomeni çnjerzor”.

STATISTIKAT

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
30	21	6	2	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyre 150

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

PËRMBEDHJE EKZEKUTIVE

Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë vitit 2022 është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kujdes Parësor Shëndetësor 2020-2024, Strategjinë dhe Planin Veprimit për Përfshiren Sociale 2022-2024, Planin e Punës për vitin 2022 si dhe implementimin e rekomandimeve nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës kundër pandemisë Covid19.

Objektiv i përgjithshëm gjatë këtij viti ka qenë ofrimi i shërbimeve cilësore nga Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) të cilati përgjigjen më mirë nevojave të pacientit dhe komunitetit, duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës.

Për të siguruar shërbime shëndetësore të qasshme dhe mëcilësore ne kemi vlerësuar se duhet të bëhet përmirësimi i kushteve të punës për ata që ofrojnë dhe ata që marrin shërbime shëndetësore. Si rrjedhojë, jemi angazhuar në përmirësimin e infrastrukturës brenda institucioneve shëndetësore dhe kompletimin e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore.

Duke marrë për bazë se preventiva, edukimi dhe identifikimi i hershëm zvogëlon rrezikun për sëmundje, paaftësi dhe vdekje, gjatë këtij viti kemi intensifikuar aktivitetet tona në zvogëlimin e sëmundshmërisë përmes edukimit dhe kujdesit shëndetësor të popullatës.

Në mënyrë që stafi menaxherial dhe mjekësor të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore kemi fuqizuar mekanizmat e mbikëqyrjes mbështetëse dhe menaxhimit të cilësisë, jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, janë marrë masat për parandalim të infeksioneve të zbatuara nga gjithë profesionistët shëndetësor.

Marrë parasysh zhvillimin e hovshëm të TI dhe kalimin e shumë shërbimeve nga shërbime fizike në shërbime digjitale, jemi angazhuar në funksionalizimin e SISH-it në të gjitha IKPSH-të dhe disa pilot projekte për ofrimin e shërbimeve shëndetësore digjitale.

Kemi vazhduar me masat e rekomanduara nga MSH dhe IKShPK për pandeminë Covid-19 dhe kemi krijuar kushte të përshtatshme për vaksinim si dhe për testim kundër pandemisë Covid19.

Kemi punuar ngushtë me Qendrën për Punë Sociale (QPS-në) me qëllim të identifikimit të vështirësive, sfidave dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale. Është zgjidhur problemi i transportit dhe është gjetur një zgjidhje për orët e kujdestarisë.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Përfshirjen Sociale 2022-2024 është aprovuar nga Kuvendi Komunal dhe ka filluar implementimi i aktiviteteve të planifikuara në Planin e Veprimit.

Në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në vitin 2022 gjendja, duke përfshirë edhe shëndetin e rezidentëve, në përgjithësi ka qenë e mirë.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Qasja strategjike më ndryshe dhe pragmatike e aplikuar në vitin 2022, hartimi i një plani të veprimit si dhe hartimi i një plani të punës të thjeshtë, të matshëm dhe të realizueshëm brenda një viti kalendarik kanë rezultuar të suksesshme në:

- Avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore në kuadër të mjekësisë familjare,
- Avancimin e shërbimeve laboratorike duke bërë rritjen e numrit të analizave të ofruara në gjithsej 38 parametra dhe shkurtimin e kohës për ofrim të analizave,
- Shkurtimin e kohës së pritjes në shërbimin e radiologjisë diagnostike,
- Rritjen e numrit të shërbimeve stomatologjike dhe rritjen e sigurisë gjatë ofrimit të shërbimeve,
- Rritjen e shërbimeve dhe vizitave për nënat në sektorin e maternitetit dhe gjinekologjisë,
- Avancimin dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin shëndetësor të angazhuar në ofrim të shërbimeve në institucionet shëndetësore në Lipjan,
- Përmirësimin e higjienës dhe avancimin e mirëmbajtjes në QKMF, QMF dhe AMF.

Me qëllim të marrjes së vendimeve të informuara mirë, duke zgjeruar komunikimin dhe dialogun me komunitetin dhe pacientin, në këtë vit është themeluar Këshilli i Pacienteve. Ky organ është i përberë nga pesë anëtarë.

Në kuadër të avancimit të komunikimit jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve në përmirësimin e mëtutjeshëm të komunikimit dhe qasjes ndaj pacientit. Janë organizuar dy konsultime publike, njëri me komunitetin dhe pacientët ndërsa tjetri me personelin shëndetësor dhe organizatat e shoqërisë civile. Këto konsultime publike janë përkrahur nga OSBE. Qëllimi themelor i këtyre konsultimeve ka qenë identifikimi i nevojave, diskutimi i vështirësive dhe gjetja e mënyrave për të avancuar më tutje shërbimet shëndetësore. Më tutje, mbështetur nga AQH, është organizuar trajnim dy ditor për personelin shëndetësor në fushën e komunikimit.

Është bërë përkrahja dhe fuqizimi i Institucioneve shëndetësore në fshatra. Ka përfunduar renovimi i QMF Shalë, ka filluar renovimi i QMF Gadime. Për QMF Gadime kemi siguruar pajisje dhe aparatura të nevojshme si: karrige stomatologjike, autoclav, sterilizator, numërues hematologjik, mikroskop dhe pajisje tjera të nevojshme për ofrim të shërbimeve cilësore. Në QMF Janjevë kemi dërguar një numërues hematologjik dhe kemi funksionalizuar shërbimin e laboratorit.

Është shënuar Viti i Përonave me Aftësi të Kufizuara, përmes lëshimit në përdorim të Ashensorit në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan. Ky projekt ka rëndësi të veçantë për personat me aftësi të kufizuara ngase ju ofron qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore në katin e dytë dhe të tretë në QKMF.

Në bashkëpunim me AQH dhe OJQ POLIS kemi implementuar Fletë Notimin Komunitar ku janë përfshirë aktivitetet dhe masat për implementimin, monitorim dhe realizim të objektivave dhe aktiviteteve brenda afateve kohore të përcaktuara në Planin e Veprimit 2022-2024.

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Për të siguruar implementimin e plotë të konceptit të mjekësisë familjare jemi angazhuar për Riorganizimin, përmirësimin e kushteve dhe avancimin e shërbimeve shëndetësore në Departamentin e Mjekësisë Familjare duke bërë

riorganizimin e ordinancave brenda QKMF-së. Me këtë riorganizim kemi krijuar hapësirë të mjaftueshme për tetë ordianca të shpërndara në katin përdhësë dhe katin e parë. Secila ordinancë është e përbërë nga para dhoma për infermier dhe dhoma e mjekut. Kjo mundëson ambient të mirë për ofrim të shërbimeve dhe kryerjen e detyrave si për mjekun ashtu edhe për infermierin. Secila ordinancë është pajisur mirë me të gjitha instrumentet dhe pajisjet e nevojshme për dhënie të shërbimit cilësor shëndetësor.

Në vitin 2022, jemi përzgjedhur një ndër katër komunat për projektin e Zonimit nga MSH. Me implementimin e këtij projekti, koncepti i mjekësisë familjare do të implementohet në tërësi.

Në mbështetje të avancimit të mëturjes së cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe rritjes së saktësisë, sektori i Laboratorit, Stomatologjisë, Gjinekologjisë, Urgjencës, Radiologjisë dhe sektorët tjerë janë furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja shëndetësore të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara, saktësi dhe shkurtim të kohës së pritjes.

Higjiena dhe mirëmbajtja në institucione shëndetësore ka arritur nivelin e duhur, do të angazhohemi që të sigurojmë qëndrueshmëri. Kemi kryer inspektime të rregullta në ambientet në QKMF. Jemi takuar me menaxhmentin e QKMF-së dhe kemi diskutuar standardet dhe kërkesat e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale rreth higjienës dhe mirëmbajtjes. Në takime po ashtu kemi diskutuar, nevojat, vështirësitë dhe sfidat të cilat burojnë për shkak të numrit të madh të pacientëve të cilët frekuentojnë ambientet shëndetësore.

Me qëllim të menaxhimit më të mirë të sistemit të radhës dhe kohës së pritjes për të marrë shërbimet mjekësore në QKMF, kemi implementuar sistemin elektronik të pritjes së radhës. Për menaxhimin e sistemit të radhës, gjatë kësaj periudhe raportuese, kemi fituar një donacion nga Solaborate. Jemi takuar disa herë me donatorin Solabroate nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me përfaqësi edhe në Prishtinë dhe kemi filluar të punojmë në implementimin e sistemit elektronik të pritjes. Ky projekt, përveç programit me specifikat e QKMFsë në Lipjan, përfshinë edhe furnizimin me display orientues digjital të cilët do të vendosen mbi secilën ordinancë dhe një display të madh në hyrje të QKMF-s. Më tutje, me qëllim të organizimit më të mirë të punës dhe shërbimeve mjekësore, jemi fokusuar në implementimin e SISH-it dhe kartelës elektronike të pacientit. Edhe përkundër problemeve teknike si rënia e kohëpaskohshme e serverit të SISH-it në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rrjetit, është shënuar rritje në përdorimin e Sistemit Informativ Shëndetësor. Është zhvilluar Ëebfaqja për QKMF nga AQH. Kështu kemi adresuar implementimin e kutisë elektronike të ankesave në QKMF, QMF, AMF dhe urgjence. Jemi pajtuar që ky funksion të përfshihet në ëbfaqen e QKMF-së dhe të monitorohet nga menaxhmenti i QKMF-së dhe DSHPS-së.

Ka filluar të implementohet pilot projekti i Telemjekësisë në AMF Kraishtë. Komuna e Lipjanit është e para në nivel vendi në ofrimin e shërbimeve mjekësore përmes telemjekësisë.

Përkrahja nga AQH në këtë vit ka qenë e shkëlqyeshme dhe është shtrirë në disa fusha si: Kujdesi i integruar, menaxhimi cilësor i shërbimeve, komunikimi me pacient, investime kapitale, formimi i këshillit të pacienteve, etj. Po ashtu, me AQH-në kemi mbajtur takime për zbatimin e projektit Qendrat Demonstruese në QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë.

Në kuadër të edukimit dhe promovimit të shëndetit janë organizuar një sërë aktivitete:

- Është shënuar dita kundër TB me datë 24 Mars 2021, si dhe me rastin e shënimit të ditës së shëndetësisë me 7 prill kemi mbajtur një ligjëratë me qytetar të Komunës së Lipjanit ku janë njoftuar me strukturën organizative, shërbimet e KPSH, sasinë dhe cilësinë e shërbimeve si dhe vështirësitë tona dhe të qytetarëve në marrjen e shërbimeve shëndetësore në KPSH.
- Dita botërore e Zemrës në përkrahje të AQH-së organizuar në Sheshin "Adem Jashari" dhe në lagjen të Xhamia,
- Dita botërore kundër diabetit 14 Nëntor 2022, në Sheshin "Adem Jashari" dhe në lagjen të Xhamia,
- Dita kundër HIV/AIDS, 1 dhjetor 2022,
- Ligjërat me qytetar (Pacient) nga OJQ KOPF në AMF Kraishtë, me banor nga Ribari i Madh dhe Kraishta, në Brus, Magure, Shalë, Gadime etj.
- Karnevali "Përshëndetje" me aktivitete vetëdijesuese në Magure.

Sektori i Infermierisë

Në sektorin e infermierisë është arritur koordinim i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve gjatë pandemisë, si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës. Po ashtu, janë organizuar planifikim i trajnimeve të stafit dhe shënimi i ditëve të caktuara në shëndetësi. Ky shërbim ka bartur punën e kryerjes së stazhit të gjithë praktikantëve të infermierisë, mbi 200 praktikant/e.

Sherbimi i Urgjences

Shërbimi i Urgjencës është duke vazhduar të përmirësohet dukshëm. Është bërë fuqizimi i shërbimit të urgjencës me personel, pajisje dhe automjete.

Planifikimi dhe mobilizimi me kohë për përballim të numrit të madh të pacientëve gjatë ardhjes në pushim të mërgimtareve në sezonin e verës dhe gjatë festave të fund vitit ka dhënë rezultate të mira. Kjo qasje ka rezultuar e suksesshme ngase ky vit ka qenë ndër vitet e pakëta që nuk është përcjellë me probleme gjatë këtyre periudhave kohore të lartshënuara.

Në shërbim të Urgjencës gjatë një ndërrimi janë nga dy mjek për arsye të vëllimit të madhe të punës brenda dhe krijimi i mundësisë së daljes në teren. Ky shërbim është i ngarkuar me numër të madh të pacientëve, si rrjedhojë edhe shpenzuesi i më shumë se gjysmës së furnizimit me material mjekësor dhe terapi.

Sektori i Laboratorit

Shërbimi i Laboratorit ka filluar të ofroj të gjitha analizat, 38 analiza, siç specifikohet me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet administrative për kujdesin parësor shëndetësor. Për të krijuar këtë mundësi, laboratorit është pajisur me aparaturat e nevojshme shëndetësore bashkëkohore si: aparat biokimik, numërues hematologjik, mikroskop, dhe aparatura tjera për nevoja të këtij shërbimi si në QKMF ashtu edhe në punkte. Kjo aparaturë e mirë tani ka mundësuar ofrimin e analizës HbA1c/Hemoglobina e glikogjenizuar. Gjatë vitit nuk kemi pasur vështirësi në furnizim me material laboratorik dhe kemi shtuar edhe 4 analiza në këtë sektor. Teste rapide me antigen u janë ofruar rreth 12000 qytetarëve.

Sektori i Radiologjisë Diagnostike

Kemi eliminuar nevojën për pritje të gjata për shërbime të rëntgenit në sektorin e Radiologjisë. Përmirësimit të sektorit të radiologjisë diagnostike dhe shërbimeve laboratorike i kemi adresuar duke vendosur komunikim të drejtpërdrejtë me këtë sektor. Gjatë takimeve kemi identifikuar gjendjen e pajisjeve dhe aparaturave mjekësore, kemi identifikuar nevojat për aparatura shtesë dhe kemi siguruar një rëngën digjital i cili ka hyrë në funksion këtë vit. Në Shërbimin e Radiologjisë diagnostike në QKMF do të kemi mundësi të ofrojmë teste radiologjike specialistike me kohë sipas kërkesave të mjekëve familjar, pediatrik, stomatologëve dhe mjekëve të profileve tjera shëndetësore.

Sektori i Stomatologjisë

Në sektorin e stomatologjisë nga fundi i këtij viti kemi arritur të ofrojmë pakon me shërbimet e kompletuara stomatologjike duke filluar nga fotografimi, shërimi, mbushja, nxjerrja e dhëmbit dhe pastrimi. Ky përmirësim në këtë sektor është arritur duke bërë riorganizimin e stafit dhe përmirësimin e kushteve të punës. Sektori i Stomatologjisë është pajisur me katër karrige të reja stomatologjike, tre autoclav dhe 10 sterilizator.

Sektori i Maternitetit

Ky shërbim ka shënuar rënie të lindjeve, por tani janë orientuar vizitat dhe këshillat për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, po ashtu edhe klasa për nëna. Jemi duke realizuar vizita shtëpiake, kurse vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog. Renovimi i objektit ka përmirësuar dukshëm kushtet e punës si dhe pajisja me karrige për ekzaminim, me sonda të reja për ECHO dhe aparat CTG.

Shërbimi i Pneumoftiziologjisë

Është shënuar rritje e numrit të sëmurëve me TB. Gjithsej janë evidentuar 42 raste, nëntë raste me shumë se në vitin 2021.

Sektori i Vaksinimit

Nga fillimi i procesit të vaksinimit kundër Pandeminë Covid19 janë zbatuar dhe janë në vazhdimësi duke u zbatuar rregullat dhe protokollet e caktuara sipas planit. Gjatë vitit 2022 janë vaksinuar me të katër dozat gjithsej 4616 qytetarë (Doza e parë - 866, Doza e dytë - 1414, Doza e tretë- 2306, doza e katërt -30). Deri më tani janë raportuar 8 efekte anësore. Rreth 12000 qytetarë janë testuar me teste rapide me antigjen.

Vaksinimi sipas grup moshave me Vaxigrip-vaksinë nga data 30.10.2022-11.01.2023:

Nr	Grupimi	Të vaksinuar
1	Të vaksinuar mbi 65 vjet	1454
2	Të vaksinuar me sëmundje shoqëruese (indikacion)	1052
3	Të vaksinuar puntorë shëndetësor	76
	Gjithsej vakcina të aplikuara	2582

Sektori i Barnatores

Kemi një përmirësim në shpërndarjen, planifikimin si dhe evidentimin e stokut. Furnizimi me barna është bërë sipas planifikimit të gjashtë muorit të parë dhe gjashtë muorit të dytë për çdo muaj sipas kërkesës. Jemi furnizuar mirë me Insulina dhe nuk ka pasur mungesë për pacientët. Ndërsa me material shëndetësor kemi qenë të furnizuar pjesërisht. Me barna tabletare furnizimi nuk ka qenë i dobët, ndërsa ka munguar furnizimi me terapi ampulare. Nga vlerësimi i i furnizimit sipas numrit të artikujve (172 artikuj) nga lista esenciale furnizimi ka qenë **37.55%**.

Departamenti i Administratës

Nr.Rend	Emërtimi i Aktit	Nr. i aktive
1	Aktvendime për shfrytëzim të pushimit vjetor	280
2	Aktvendime për pagesën e punës së nates, jashtë orarit, festës	33
3	Aktvendime mbi masat disiplinore (Vërejtje)	3
4	Lëshime të vërtetimeve për përvojë të punës për ish punëtorët dhe punëtorve aktual	25
5	Evidentimi dhe procedimi i pushimeve mjekësore	50
6	Evidentimi dhe procedimi i lindjeve në nënsin e maternitetit	1
7	Aktvendimet për pushimet e Lehonis për punëtorët	3
8	Largim nga puna me vetëdëshirë dhe të larguar me procedurë të rregullt	/
9	Pushimet pa pagesë	5
10	Rekrutime të reja të punëtorëve	12
11	Vërtetima që kanë përfunduar praktiken në QKMF	130
12	Vërtetima që kanë qenë në praktik vullnetare në QKMF	2
13	Aktvendime për daljen në pension të punëtorëve	5
14	Aktvendim për ndërprerjen e punës së punëtorëve që kanë vdekur	/
15	Aktvendime të ndryshme dhe shkresa të ndryshme .	20
16	Ndryshime në listën e pagave të punëtorëve për vitin 2018	200
17	Pregaditja e pagesës për shtesat Covid-19	12
18	Pregaditja e Autorizimeve për praktik	326
Gjithësej:	Lëndet e punuara janë:	1,070.00

Sektori i Financave

Nr.	Emertimi i shpenzimeve	Vlera e alokuar në €	Vlera e shpenzuar në €
1	Pagat dhe medijtjet	1658864.59	1,582,782.93
3	Mallra dhe shërbimet	220148.22	208,712.67
4	Komunaliet	49736.7	49,679.47
5	Shpenzimet Kapitale	249969	156,189.08
TOTALI		2,178,718.51	1,997,364.15

Sektori i Mirëmbajtjes

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim i theksuar. Është shënuar përparim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-s, QMFve dhe AMFve.

Sektori i Autogazhës

Është shënuar rënie e shpenzimeve të derivateve. Kemi edhe një orar të ri me pacientet e hemodializës si dhe shtim të pacientëve të ri. Është formuar komisioni për vërtetimin dhe evidentimin e shpenzimeve të derivateve në automjetet e QKMF-së. Servisimi është bërë me kohë i të gjitha automjeteve të QKMF-së.

Përmbledhje e vizitave dhe shërbimeve mjekësore në QKMF, QMF dhe AMF-Lipjan

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar shëndetësor në Komunën e Lipjanit përkundër vështirësive me pandeminë, vaksinimin kundër Covid-19, nuk është ndërprerë asnjëherë. Kjo dëshmohet me 461872 vizita mjekësore dhe shërbime shëndetësore të ofruara brenda vitit.

Nga AQH jemi përzgjedhur si qendër demonstruese për implementimin e projektit të AQH dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në kujdesi parësor shëndetësor.

Shërbimet shëndetësore

01	Vizita mjekësore në QKMF	101814
02	Vizita mjekësore në Punte	48442
03	Vizita emergjente	48488
04	Vizita stomatologjike	5526
05	Vizita gjinekologjike	8283
06	Vizita pediatrike	6582
07	Vizita pulmologjike	460
08	Vizita paliative	1371
09	Gjithsej vizita mjekësore	220966
01	Gjithsej injeksione	89292
02	Gjithsej infuzione	38497
03	Gjithsej lidhje-pastrim plage	16778
04	Gjithsej Rtgeponime	3730
05	Gjithsej pacient në laborator	22611
06	Gjithsej lindje	4
07	Gjithsej EKG infirmieris	5533
08	Gjithsej vizita shtëpiake me autoambulancë	633
09	Gjithsej USG	1354
10	Rrahje	66
11	Gjithsej transport me autoambulancë	1459
12	Gjithsej Imobilizime	503
13	Gjithsej Oksigjenoterapi	1275
14	Gjithsej Largim i Penjve	1175

15	Gjithsej aksident trafiku	420
16	Këshillimorja	1160
17	Gjithsej vaksina	15499
18	Teste rapide me antigjen	11897
19	Gjithsej vaksina COVID-19	4617
20	Referime	20480
21	Inhalime	406
22	Vizita Infermierike Gjinekologjike	1364
23	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjeç	1365
24	Klasa për nëna në 1000 ditët e para	401
25	Vizita në qendrën e azilil-Magure	31
26	Vizita në qendrën e paraburgimit	66
27	Konstatim vdekje/Mortusadlatae	89
28	Thimbim nga rriqrat	185
29	Dhunë familjare	16
30	Gjithsej shërbime	240906
	Përqindja e referimeve	10.00%

Projektet te realizuara

- Realizimi i fletë notimit komunitar për herë të tretë në Lipjan me fokus për pacientet me diabet,
- Furnizimi me pajisje të telemjekësisë dhe trajnimi i stafit për përdorimin e pajisjeve të telemjekësisë si dhe funksionalizimi në maj – qershor të viti 2022,
- Realizimi i Auditit dhe Riauditit me përkrahje të AQH-së dhe rishqyrtimi kolegjal, me fokus në analizimin e referimit në shërbimin e diagnostikues: laborator dhe rëntgen,
- Plotësim dhe furnizim me glikometër dhe inventar i Këshillimores në QKMF nga AQH-projekti për shërbime shëndetësore të integruara,
- Broshura për njoftimin e qytetarëve lidhur me KPSH dhe shërbimet të cilat ofrohen në këto institucione, për edukim lidhur me përdorimin e kripës dhe sheqerit, diabetin dhe hipertensionin etj, donacion nga AQH,
- Vizita studimore në Slloveni për organizimin e Kujdesit Primar Shëndetësor,
- Organizimi i vizitave dhe aktiviteteve në natyrë me moshat 65+ vjeç në kuadër të zhvillimit të shërbimeve shëndetësore të integruara,
- Takime pune dy ditore në Dragash me përkrahje të AQH-së lidhur me implementimin e shërbimeve shëndetësore të Integruara,
- Pjesëmarrja në konferencën ndërkombëtare Odense-Danimarkë, për shërbime shëndetësore të integruara në Qershor 2022.

Investimet kapitale

- Fillimi i renovimit të QMF-Gadime, bashkëfinancim në mes të Komunës së Lipjanit dhe AQH-së.
- Në fillim të vitit ka filluar realizimin projektit nga DSHPS, për përmirësimin e kushteve të punës me renovime në QKMF, QMF-Shalë dhe Magure,
- Furnizimi me aparatura dhe pajisje mjekësore (Aparat biokimi automatik, aparate hematologjike për QKMF dhe QMF, karrige stomatologjike, karrige gjinekologjike, autoclav katër copë dhe sterelizator, pajisje stomatologjike),
- Furnizimi me autoambulancë me komplet pajisjet e autoambulancës,
- Furnizimi nga MSH me pajisje për shërbimin e Urgjencës,
- Sigurimi i aparatit të rëntgenit dhe digjitalizer,
- Është lëshuar në punë ashensori në QKMF, projekt me AQH-në,
- Rregullimi i rrjetit të ujësjellësit në QMF-Magure dhe objektin e emergjencës dhe stomatologjisë,
- Renovimi i tualeteve në QKMF,
- Furnizimi me 10 oksigjen konsentrator, donacion nga Islamik Relief.

Shërbime të reja të ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga KPSH-Lipjan

- Vizita virtuale përmes telemjekësisë nga AMF - Kraishtë në QKMF - Lipjan,
- Formimi dhe funksionalizimi i komisionit për cilësi dhe shqyrtim të ankesave dhe parashtrësve nga pacientët dhe stafi,
- Vizitat shtëpiake me autoambulancë dhe staf mjekësor për pacientët me raste të veçanta dhe rastet terminale,
- Komunikimi i rasteve për shqyrtimin e përkrahjes sociale pas vizitave nga ekipi i infermiereve për vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç (shërbime shëndetësore të integruara),
- Vizita dhe shërbime shëndetësore të integruara me punëtor social nga QPS për personat 65 vjeç e mbi me fokus në diabet, hipertension dhe astma,
- Krijimi i një baze të dhënave elektronike për shërbimet shëndetësore të integruara.
- Krijimi i Eëb-faqës së QKMF-së,
- Promovimi i shëndetit për nënat dhe fëmijët në komunitet me 40 sesione dhe shpërndarja e 400 pakove/dhuratave të fituara nga projekti me AMC vlera e projektit 10,000.00€.

Edukimi Posdiplomik Specialistik

Në kuadër të edukimit specialistik nga QKMF-Lipjan janë gjashtë (6) mjekë në specializim të mjekësisë familjare, një në Pediatri dhe një në Biokimi. Pas përfundimit të këtyre specializimeve Komuna e jonë do të jetë ndër Komunitet e para që i afrohet planit strategjik kombëtar një Mjek Familjar në 2000- 2500 banor.

Qendra për Punë Sociale

Kuvendi Komunal ka aprovuar Strategjinë për Përfshirje Sociale 2022-2024 dhe Planin e Veprimit për implementim të kësaj strategjie. Të gjitha procedurat ligjore janë respektuar, si mbajtja e dëgjimeve publike, konsultimi me komitetet relevante të Kuvendit Komunal dhe konsultimet me OJQ.

Ne bashkëpunim me Këshillin Komunal Koordinues në Mbrotjtje të Viktimave të Dhunës në Baza Gjimore-Lipjan kemi bërë përgatitjet për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në kuadër të 16 ditorit të viktimave të dhunës në familje dhe baza gjimore. Kemi marrë pjesë në Konferencën e organizuar nga OSBE "Përmirësimi i qasjes së të mbijetuarave të dhunës në baza gjimore në nisma për banim social dhe zhvillim ekonomik".

Aktivitetet e realizuara:

- Aktivitet monitoruese dhe mentoruese lidhur me procesin e mbarëvajtjes së shërbimeve sociale në QPS, me qëllim të orientimit të shërbimeve në kuadër të kapaciteteve aktuale kadrovike, konform politikës sociale në përmbushje të nevojave të qytetarëve për shërbime sociale.
- Zbatim i rregullt i praktikës së raportimit dhe informimit, me qëllim të zhvillimit të shërbimeve në koherencë me nevojat e qytetarëve për, mbajtje në nivel të përgjegjësisë dhe orientim të shërbimeve në kuadër të Qendrës për Punë Sociale.
- Implementim të planeve mujore, periodike, vjetore në kuadër të SHS, SHNS, SHAF në QPS, gjatë vitit 2022.
- Identifikim dhe ngritje e kapaciteteve profesionale për zyrtarët e QPS-ës, përmes trajnimeve për shërbime sociale.
- Realizim të vizitave studimore në ngritje të kapaciteteve profesionale, krahasim të praktikave vendore me ato rajonale në trajtimin e kategorive të caktuara nga ofruesit e shërbimeve sociale. Realizuar keto vizita në Kroaci dhe Çeki, nga dy zyrtar social në kohëzgjatje prej nëntë ditë pune.
- Pjesëmarrje e zyrtarëve socialë si ekspert të fushës në grupe punuese për hartim të akteve administrative, udhëzime, ligjeve; Ligji për SNS, UA për strehim, OK, AK, Personat e ri-atdhesuar etj.
- Realizim i disa aktiviteteve në Lipjan dhe disa lokalitete të Lipjanit rreth mekanizmit kundër dhunës në familje, siguria, prona, buxheti, barazia gjimore dhe lidhshipi
- Aktivitet koordinues dhe bashkërendues në realizimin e objektivave të parapara në implementim të strategjisë për shërbime sociale dhe familjare nga "People in need" për 2022/23.
- Aktivitet me sektorin publik privat, organizatat vendore e ndërkombëtare për të subvencionuar kategoritë e ndryshme në nevojë, si rrjedhojë e krizës globale përfshirë edhe komunitetet e Lipjanit. Mbështetur nga UNDP, Islamik Relif Kosova, MFPT. Kompanitë si: Ujësjetësi, Mbeturinave, KEDS, etj.

- Realizim i aktivitetit në kuadër të tryezës për menaxhimin e rasteve, të fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë sipas Memorandumit. Mirëkuptimit lidhur ndërmjet Komunës së Lipjanit me Organizatën "TerredesHomes".
- Bashkëpunim me OFAP në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve në strehim familjar, ofrim i shërbimeve psikologjike, vazhdimisht.
- Zbatimi i planit të veprimit në kuadër të strategjisë për Shërbime sociale dhe familjare, miratuar 2022-2024
- Realizim i të drejtave të qytetarëve përmes CRPK (Programit për të Drejta Civile), gjatë tërë vitit për raste të caktuara në nevojë.
- Aktivitet në partneritet me QKMF në ofrim të shërbimeve të integruara dhe cilësore në komunitet, për personat e moshuar me sëmundje kronike dhe pa përkujdesje familjare.
- Aktivitet raportues planifikues monitorues, dhe kreativ me AQH rreth zbatimit të programit për shërbime cilësore dhe të qasshme në komunitet, për personat me sëmundje kronike mbi 65 vjet.
- Marrje e veprimeve operative me policinë e Kosovës, (kohë pas kohe, mobilizim i ekipeve vepruese ndër-institucionale në teren) në mbrojtje të fëmijëve në situatë rruge, kryesisht kërkues lëmoshe.
- Zhvillimi i strehimit familjar, përzgjedhja e një familje të re.
- Ofrim i shërbimeve përkrahëse (ndihmë sociale, kujdestari, shërbime profesionale, avokim, intervistim) sipas legjislacionit për shërbime sociale dhe familjare, për individ dhe familje me status të mbrojtjes ndërkombëtare në Qendrën e Azilit Magure.
- Aktivitet i vazhdueshëm me Zyrën për Komunitete, MPB në vlerësimin e nevojave për familjet e ri-atdhesuara, verifikim dhe vlerësim të nevojave si dhe në ofrim të shërbimeve sociale. Koordinim aktiviteti dhe participim me një anëtar në komisionin komunal për shqyrtim të rasteve, në proces të ri-integrimit për familjet e ri-atdhesuara.
- Bashkëpunim me zyrën për ndihmë juridike falas.

Sensibilizim rreth parandalimit të dhunës në familje gjatë tërë vitit, me theks të veçantë vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit përmes fushatës nga 25.11.2019/10.12. 2019.

SHËRBIMI SOCIAL-PROFESIONAL

Qendra për Punë Sociale (QPS), si Institucion përgjegjës për zbatimin e politikave dhe legjislacionit rregullativ të mirëqenies sociale në organizimin dhe ofrim të shërbimeve sociale e familjare brenda kompetencës ligjore dhe territoriale të komunës ku vepron, përmes Shërbimit Social (SHS) kapaciteteve humane njerëzore, profesionale, për kategori të ndryshme të personave në nevojë për mbrojtje sociale, siç përcaktohen në Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, ka realizuar përkujdesje sociale, këshillim dhe në raste të veçanta, ndihmë materiale për klientët në nevojë sociale, përfshirë:

- fëmijët pa kujdes prindëror;
- fëmijët me sjellje asociale;
- delikuentë të mitur; marrëdhëniet e çrregulluara familjare; sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike, aftësi të kufizuara mendore, sëmundje mendore, rrezik nga shfrytëzimi apo abuzimi, dhuna në familje, trafikimi njerëzor, varësi nga alkooli ose droga, fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara ose emergjencat, ose shkaqe të tjera që i bëjnë personat nevojtarë.

Klientet dhe shërbimet sociale:

Nr.	Klientet		Nr.	Shërbimet	
1.	Fëmijët e braktisur Fëmija jetim	4	1.	Fëmijë të braktisur	8
2.	Klient për familje strehuese –streh.fam.	1	2.	Vendosja e fëmijëve në shtëpinë transitore	5
3.	Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar me status të huaj	10	3.	Vendosja në strehim familjar	5
4.	Fëmijët e prindërve të penguar në kryerjen e detyrave.	5	4.	Bashkimi familjar – kthimi në familje	3
5.	Fëmijët e keqtrajtuar (lënë pas dore).	8	5.	Kujdestari	37
6.	Fëmijët me sjellje asociale	27	6.	Shërbime për të miturit në konflikt me ligjin	457
7.	Të miturit në konflikt me Ligjin(delikuentet)	249	7.	Vendosja në strehim për viktimat e dhunës	7
8.	Viktimat e dhunës në familje	85	8.	Vlersime për të miturit që kërkojnë të hynë në martesë.	2

9.	Mendime profesionale për të mitur në gjykatë	131	9.	Këshillim për bashkëshortet në martesë	79
10.	Viktimat e krimeve seksuale	9	10.	Besim i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore	38
11.	Viktimat e vendosura në strehimore për viktimat e dhunës	4	11.	Kontaktimet prind fëmijë	61
12.	Martesa e parakohshme që dëshirojnë të hynë në martesë.	2	12.	Intervenime për viktimat	95
13.	Klient në nevojë për Këshillime martesore	43	13.	Intervenime të përgjithshme	2100
14.	Të moshuarit në nevojë për shërbime	4	14.	Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara	325
15.	Klient tjerë në nevojë për shërbime	535	15.	Shërbime për të rritur me aftësi të kufizuara	4
16.	Përdoruesit e substancave narkotike	3	16.	Shërbime për të moshuarit	65
17.	Reintegrimi i fëmijëve	10	17.	Këshilla psiko- sociale	80
18.	Puna e rrezikshme e fëmijëve	1	18.	Sanim i marrëdhënieve familjare	2
19.	Fëmijët me Aftësi të Kufizuara	30	19.	Intervenime gjatë orarit të kujdestarisë	183
20.	Të rritur me aftësi të kufizuara	4	20.	Përfaqësues të përkohshëm	11
				Pjesëmarrja në seanca Gjyqësore e ZSHS-ve	60
	Numri i përgjithshëm i klientëve	1160		Numri i përgjithshëm i shërbimeve	3627

SHËRBIMI I NDIHMAVE SOCIALE

Sektori për Mirëqenie Sociale

Shërbimi i ndihmave sociale edhe këtë vit ka zhvilluar aktivitete në harmoni me politikën sociale, programin e punës për vitin 2022, të lëshuara nga MFPT.

Gjatë kësaj periudhe raportuese kemi pasur numër të madhë të kërkesave të reja për shkak të rrethanave socio-ekonomike, të zhvilluara nga pasojat socio-ekonomike që ka shkaktuar PANDEMIA COVID 19. Në sajë të angazhimit të shtuar në këtë shërbim rreth procesimit të lëndëve dhe përzgjedhshmërisë së familjeve në nevojë për ndihmë sociale, e po ashtu në sajë të aktivitetit të shtuar për zbatim ligjorë dhe respektim të kriterëve të SNS-ës.

Në Janar të këtij viti shërbimi i SAS-it kishte 1314 familje me numër të anëtarëve 5800, me shumë totale prej 179,350.00€ në muaj, tani në fund të vitit në muajin Dhjetor/2022 kemi 1202 familje, me numër të anëtarëve 4271 me shumë 162,000.00€.

Nga kjo del se numri i shfrytëzuesve të ndihmave sociale për periudhën janar-dhjetor 2022 është në rënie për 112 familje dhe është zvogëluar për 1529 anëtarë të familjes.

SHTËPIA ME BAZË NË KOMUNITET

Gjendja e përgjithshme e fillimit të vitit 2022 ka qenë e mirë dhe ka filluar si zakonisht me kryerjen e punëve dhe detyrave të zakonshme.

Problem i cili na ka përcjellë në fillim të vitit 2022 ka qenë mbingarkesa me rezident. Në përkujdesje kanë qenë njëmbëdhjetë (11) rezidentë përderisa institucioni ka kapacitet të shtretërve vetëm për dhjetë (10) rezidentë, e që në muajin Prill një rezident është transferuar në Shtëpinë me bazë në komunitet Prizren, dhe tutje situata ka qenë e normalizuar dhe sipas kapaciteteve normale që posedon Shtëpia jonë.

Gjatë këtij viti janë vaksinuar të gjithë rezidentët e Shtëpisë së Komunitetit me një dozë të vaksinave në mbrojtje nga gripi sezonal, gjë e cila u bë nga qendra e Vaksinimit të QKMF Lipjan.

Edhe këtë vit kemi pas sigurimin fizik të objektit ku është lehtësuar puna për stafin shëndetësorë pasi që kanë punuar vetëm në shërbim të rezidentëve duke mos pas obligime për pjesën e jashtme të objektit.

Gjatë këtij viti në çdo aktivitet të zhvilluar kemi pas kujdes të veçantë duke mbrojtur shëndetin e të gjithë rezidentëve tanë.

Në muajin Maj dhe Shtator i kemi dërguar të gjithë rezidentët e Shtëpisë së Komunitetit për qëndrim në kohëzgjatje prej shtatë (7) netë dhe tetë (8) ditë në Prevallë si dhe i gjithë stafi kemi qenë nën përkujdesje të rezidentëve, ku vlenë të ceket se edhe gjatë vizitave kemi pas kujdes të shtuar gjithmonë në mbrojtje të shëndetit të rezidentëve.

Po ashtu brenda objektit janë zhvilluar aktivitete të lira me rezidentë si mënyra e të ushqyerit, mbajtja e higjienës personale, mbajtja e higjienës në dhomat e gjumit, si dhe lojëra të ndryshme (me letra, vallëzim, vizatim, ngjyrosje, loja me top etj).

Statistika

Pasqyra totale e kërkesave të DSHPS-së për vitin 2022

Nr.	Lloji i kërkesës	Të pranuar	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë
1	Kërkesa për Strehim në Strehimoren Magurë	15	/	15	/
2	Kërkesat për vazhdimin e kontratave për banim në Strehimore	25	25	/	/
3	Kërkesa për ndërtim, meremetim të shtëpive	38	/	25	13
4	Kërkesa për ndarje të banesave	65	/	/	65
5	Kërkesa nga QKMF	41	30	11	/
6	Kërkesa nga QPS	38	20	10	8
7	Kërkesa nga Shtëpia e Komuniteteve	32	32	/	/
8	Kërkesa për mjete financiare	335	114	201	20
9	Kërkesa për shërim jashtë vendit	5	5	/	/
10	Kërkesa për realizimin e të drejtave të familjeve të veteraneve të luftë së UÇK, dëshmove, invalidëve, viktimave civile	4	4	/	/
11	Kërkesa për certifikata të shtesave femërore për punëtorët në botën e jashtme.	60	60	/	/
12	Aktvendime për pagesën e punëve jashtë orarit të punës për Shtëpinë e Komuniteteve	36	36	/	/
13	Aktvendime për pushim pa pagës në QKMF	2	2	/	/
14	Aktvendime për vazhdimin e qëndrimit të rezidentëve në Shtëpinë e Komuniteteve	10	10	/	/
15	Aktvendime të ndryshme	38	38	/	/
16	Aktvendime për pushim pa pagës në Shtëpinë e Komuniteteve	/	/	/	/
17	Kërkesa për punësim në QKMF	73	12	61	/
18	Kërkesa për punësim në Shtëpinë e Komuniteteve	13	1	12	/
19	Kërkesa për praktik në QKMF	430	400	/	30
20	Kërkesa për pagë jubilarë nga punëtorët e QKMF-së	/	/	/	/
21	Ankesa për pagë jubilarë për punëtorët e QKMF-së	/	/	/	/
22	Vërtetime të ndryshme	52	52	/	/
23	Kërkesa të ndryshme	83	83	/	/
24	Nr. i përgjithshëm i kërkesave	1395	924	335	136

DREJTORATI PËR ARSIM

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Sistemi arsimor në Komunën e Lipjanit organizohet në nivelet 0, 1, 2 dhe 3, me gjithsejt 28 Institucione Arsimore, prej të cilave 1 Institucion për edukimin parashkollor, 24 SHFMU dhe 3 SHML - një shkollë Gjymnaz, një shkollë Profesionale dhe një shkollë Mikse.

Ofrimi i kushteve dhe arritja e rezultateve të kënaqshme në aspektin edukativo-arsimor janë çështje të cilat DKA në vazhdimësi mundohet t'i arrijë me punë dhe aktivitete të ndryshme, gjithmonë duke synuar më të mirën për shkollën, veqanërisht përmirësimin e nevojave primare të cilat ndikojnë pozitivisht në realizimin sa më të mirë të procesit edukativo- arsimor. Ngritja e cilësisë në mësim, në veçanti përmirësimi i praktikave vlerësuese të nxënësve, ka qenë prioritet në mënyrë që shkollat tona të arrijnë në stadin e shkollave të përparuara në aspektin zhvillimor

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUES

Fillimi i gjysëmvetorit të dytë më 10.01.2022 për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme pas pushimit dimëror.

Komuna e Lipjanit, respektivisht Drejtoria Komunale e Arsimit, ka nënshkruar Memorandume Mirëkuptimi me:

Ipko Foundation, qëllimi i memorandumit ka qenë realizimi potencial i programit Bridge nga Ambasada Amerikane në

Prishtinë, në partneritet me BONEVET. Në program janë përfshirë 40 nxënës të moshave 14-18 në mësim pas-shkollor, të cilët për një periudhë 2 vjeçare do të mësojnë gjuhën angleze, do të trajnohen në programe STEM dhe tjera që ata të mund të edukohen në Amerikë apo të gjejnë punësim në Kosovë, të dyja me qëllim kontributin në shoqërinë Kosovare. Ballkan Gren Foundation, qëllimi i memorandumit ka qenë realizimi i aktiviteteve të projektit "Turneu i Gjellbër". Trajnimi e nxënësve të shkollave të mesme të larta në të menduarit kritik dhe kreativ.

ETEA, qëllimi i memorandumit ka qenë realizimi i projektit, rregullimi i bibliotekës shkollore me strategjinë e lexim-kuptimit, projekt i cili është implementuar në Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan dhe në kuadër të së cilit është bërë hapja dhe funksionalizimi i bibliotekës shkollore me strategjinë e lexim-kuptimit.

Teach for Kosova për implemmentimin e Projektit "Promovimi i të menduarit kritik dhe kohezionit multietnik tek të rinjtë" në Komunën e Lipjanit. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dy shkolla: SHML Gjumnazi "Ulpiana" në Lipjan, p.n.f Gadime dhe SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan.

Shkolla Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan është fituese e projektit:

"Fit for Jobs" nga GIZ-i gjerman, projekti ka pasur qëllim përgatitjen e nxënësve për mësim dhe është projekt që do të zgjas 3 vite.

Shkolla SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan është fituese e projektit:

"Fit for Jobs" nga GIZ ka pasur për qëllim asistimin në lidhjen e marrëveshjeve për mësimin në vendin e punës (MVP) si dhe asistimin gjatë zbatimit në MVP që do të nisë në shtator të vitit shkollor 2022, trajnimin e instruktorëve për mësimin në vendin e punës dhe trajnimin për shkathtësi të buta (soft skills).

Lux – DEV në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit, që ka pasur për qëllim mbështetjen e shkollës për profilet që i përkrah LUX-DEV, me literaturë, pajisje të kabinetëve, trajnime, furnizim me pajisje e vegla për profilet instalues elektrik, instalues i ngrohjes dhe klimatizimit e ujësjellesit, metalpunues dhe mbështetja e shkollës për procesin e njohjes së mësimin paraprak (NJMP): trajnimi i stafit të shkollës, asistimi gjatë procesit të akreditimit për NJMP.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me UNICEF-in ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan, Shfmu "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, Shfmu "Ernest Koliqi" në Babush i Muhaxherëve dhe Shfmu "Kadri Beba" në Ribar i Madh. Memorandumi ka pasur për qëllim realizimin e projektit "Mjedisi i digjitalizuar shkollor për t'i mbështetur mësimdhënësit dhe nxënësit për të mësuar gjatë tërë jetës". Lidhur me këtë është mbajtur edhe trajnim 2 ditor për mësimdhënësit.

Është bërë vlerësimi i dosjeve për mësimdhënësit e fushave: Programi parafillor dhe fillor, Artet, Jeta dhe puna, Shkencat Natyrore, Matematika, Shoqëria dhe Mjedisi si dhe Edukimi fizik. Trajnimi i mësimdhënësve të këtyre fushave është kryer në vitin 2021, ndërsa janë pajisur me certifikata nga MASHT-i gjatë vitit 2022.

Janë mbajtur trajnime të ndryshme në bashkëpunim me fakultetin e Edukimit dhe organizata ndërkombëtare për edukatorët nga Komuna e Lipjanit

Plotësimi dhe dorëzimi i databazës për nxënësit parafillor në të gjitha shkollat fillore për vitin shkollor 2021-2022 tek Caritasi Zvicerran, pastaj është përgatitur edhe raport për të gjitha Komunat, mbi të dhënat për edukimin parafillor.

Me vendim të Task Forcave të shkollave përkatëse në rastet kur numri i personave të infektuar me Covid-19 ka qenë i lartë disa shkolla kanë kaluar në mësim online: Shfmu "Emin Duraku" në Banullë ka kaluar në mësim online nga data **18.01.2022/21.01.2022**, Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan, cikli 6-9 ka kaluar në mësim online nga data **24.01.2022/28.02.2022**, SHML Gjumnazi "Ulpiana" në Lipjan ka kaluar në mësim online nga data **26.01.2022/07.02.2022** dhe Çerdhja është mbyllur nga data **26.02.2022/07.02.2022**.

Shkolla Dimërore e Skijimit në bashkëpunim me Masht-in dhe Komunën ka organizuar realizimin e projektit për nxënësit e klasave të 7-ta, konform kësaj pas aplikimit është përzgjedhur të merrë pjesë klasa e VII⁴ nga Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan. Projekti ka pasur për qëllim promovimin e kapaciteteve të Kosovës për zhvillimin e sportit malor – skijimit.

Komisioni komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka bërë vlerësimin pedagogjik të mbi 80-tetëdhjetë fëmijëve me nevoja të veçanta.

Në kuadër të marrëveshjes me UNICEF-in përmes IPKO Foundation është përmbyll instalimi i internetit në 16 shkolla të Komunës.

Për nder të festës së 7 Marsit Ditës së Mësuesit, DKA ka ndarë mirënjohje për mësime të dalluar në nivel shkollor. Gjithashtu është bërë përzgjedhja e punëtorit më të mirë në nivel Komune për vitin 2022.

Janë mbajtur mbledhje me drejtorët e të gjitha shkollave fillore dhe të mesme në të cilat takime janë diskutuar çështje të ndryshme me rëndësi rreth procesit edukativo-arsimor në shkolla. Në njërin nga mbledhjet është lansuar edhe programi (ARSLIP.SOFT) për udhëheqjen e statistikave shkollore dhe çështjeve tjera administrative.

Bazuar në **U.A Nr.106/2020**, për vlerësimin e performancës së drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar është bërë vlerësimi për 2-dy drejtor të shkollave.

Më datë **13.05.2022** ka përfunduar viti shkollor për nxënësit maturant.

Më datë **06, 10, 11 dhe 12 Maj** është mbajtur testi PISA. Në këtë test kanë marrë pjesë 9 shkolla me 200 nxënës (Shfmu "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe, Shfmu "Ibrahim Banushi" në Shalë, Shfmu "Rexhep Akllapi" në Akllap, Shfmu "Shtjefën Gjeçovi" në Janjevë, Shfmu "Vezir Kolshi" në Baicë, SHML Gjumnazi "Ulpiana" në Lipjan, SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan, Maarif School of Kosova dhe Mehmet Akif).

Është bërë miratimi i propozim rregullores mbi plotësimin dhe ndryshimi mbi ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Lipjanit.

Më datë **04.06.2022** dhe **14.06.2022** është mbajtur testi i arritshmërisë, test të cilit i janë nënshtruar gjithsejt **897** semimaturant. Më datë **22.06.2022** është bërë shpallja e rezultateve.

Më datë **18.06.2022** është mbajtur testi i maturës shtetërore, test të cilit i janë nënshtruar gjithsejt **979** maturant. Rezultatet e testit të maturës janë shpallur më datë **27.06.2022**.

Më datë **27.06.2022** është shpall konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të për Gjumnaze dhe shkollat Profesionale, për vitin shkollor 2022/2023.

Janë përgatitur të dhënat rreth suksesit të nxënësve për gjysëm vjetorin e dytë për vitin shkollor 2021/2022.

Sipas kalendarit shkollor, më datë **03.06.2022** ka përfunduar mësimi për nxënësit semimaturant (klasa e 9-nëntë) dhe për nxënësit e shkollave të mesme **10** dhe **11**, ndërsa për nxënësit e shkollës fillore (parafillorët dhe klasa 1-8) ka përfunduar më datë **17.06.2022**.

Më datë **10.06.2022** është mbajtur testi ICILS (faza pilot), në të cilin test kanë marrë pjesë nxënësit e Shfmu "Emin Duraku" në Banullë (klasa e VIII).

Pranimi i teksteve shkollore për vitin shkollor 2022/2023 nga shtëpitë botuese: Dukagjini, Libri shkollor, IrisSoft Education, Pegu, Albas, Luarasi, Magjia e Librit dhe Berati.

Në mbështetje të Komunës së Lipjanit, Shfmu "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan në ditën e shënimit të shkollës ka organizuar mbajtjen e panairit të Gjuhës, Artit, Shkencës dhe Teknologjisë P-gjashtë. Panairi në fjalë ka pasur karakter edukativ, socializues, rekreativ dhe garues.

Është bërë pranim i donacioneve:

- 11-njëmbëdhjetë laptopëve nga UNICEF-i,
- Pajisjeve kompjuterike (desktop, monitor dhe pajisje tjera) nga shoqata Shqiptare në Zvicër,
- Tavolina dhe ulëse për kabinet të tik-ut, tabela të dyfishta dhe tabela magnetike nga MASHT-i për Shfmu "17 Shkurti" në Gllgovc.

Mbajtja e testit të maturës afati i gushtit, pjesa e dytë **27.09.2022**, test të cilit i'u nënshtruan **188** maturant.

Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-dhjetë në Gjumnaze dhe shkolla profesionale-Afati i Gushtit më datë **22.08.2022**.

Përfundimi i procedurave të rekrutimit për pranimin e kuadrit të ri arsimor për vitin shkollor 2022/2023.

50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	86,618.00	219,782.48	253.74	153.74
50013 TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	40,000.00	63,201.75	158.00	58.00
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	40,000.00	24,687.43	61.72	-38.28
50045 -TAX PER LEJE MJEDISORE	30,000.00	18,221.61	60.74	-39.26
20010- TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objektev)	2,000.00	1,580.65	79.03	-20.97
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE				
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	15,000.00	18,316.30	122.11	22.11
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	55,000.00	31,921.36	58.04	-41.96
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	2,000.00	0.00	0.00	-100.00
50019- TAX TJERA ADMINISTRATIVE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS	2,000.00	3,810.00	190.50	90.50
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN				
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	500.00	301.00	60.20	-39.80
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
GJITHESEJT I:	1,854,823.00	2,033,751.37	109.65	9.65
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	45,000.00	60,085.50	133.52	33.52
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA 73200-50409	48,000.00	49,209.50	102.52	2.52
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.GLLAVICA	10,000.00	15,678.10	156.78	56.78
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	500.00	0.00	0.00	-100.00
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	500.00	100.00	20.00	-80.00
GJITHESEJT II:	1,958,823.00	2,158,824.47	110.21	10.21
GJOBAT E TRAFIKUT	100,000.00	404,444.43	404.43	304.33
GJOBAT E GJYKATES	49,500.00	46,400.00	93.74	-6.26
AGJENCIONI I PYJEVE	500.00	889.26	177.85	77.85
GJITHESEJT III:	2,108,823.00	2,610,444.43	123.79	23.79

Krahasimi të hyrave vetanake 2021-2022

Kodet Ekonomike	Realizimi 2020	Realizimi 2021	indeksi	%
50013 - TAX CERTIFIKATAT E LINDJES	47,777.00	50896	106.53	6.53
50014 - TAX CERTIFIKATAT E KURORIZIMIT	2,844.00	3,177.05	111.71	11.71
50015 - TAX CERTIFIKATAT E VDEKJES	1,189.00	1,065.00	89.57	-10.43
50016 - TAX CERTIFIKATA TJERA	3,407.00	3,084.00	90.52	-9.48
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	5,766.00	5,685.50	98.60	-1.40
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE	0.00	3,354.18		
50019- QENDRA PER SHERBIME SOCIALE	0.00	0.00		
50107 - GJOBAT TJERA	3,000.00	0.00	0.00	-100.00
16715 - PROKURIMI				
50020 - TAX E PJESMARJES NË TENDER	320.00	5,020.00	1,568.75	1,468.75
17503 - BUXHETIMI-LIPJAN				
50002 - TAX RRUGORE	126,540.00	139,374.10	110.14	10.14
40110 - TATIMI NË PRONË	1,111,415.81	1,237,276.87	111.32	11.32
- TATIMI NE TOKE				
48003 - PLANIF.ZHV.EKONOM-LIPJAN				
50290 - LIC.TJERA PËR AFARIZËM	0.00	695.00		
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	35,615.35	36,846.09	103.46	3.46
16605 - INSPEKSIONI-LIPJAN				
50104 - GJOBAT MANDTORE	2,208.16	2,110.00	95.55	-4.45
50205 - LIC.PRANIM TEKNIK TE LOKALIT	2,151.00	2,300.00	106.93	6.93
65015 - SHËRBIMET KADASTRALE-LIPJAN				

50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRYSHME	38,789.00	24,398.00	62.90	-37.10
50011 - TAX REGJISTRIMIN E TRASHIGIMIS	64,146.66	74,262.00	115.77	15.77
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	64,883.00	62,385.00	96.15	-3.85
66320 - PLANIF.URBAN.INSPEK.-LIPJAN				
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	379,049.77	219,782.48	57.98	-42.02
50013 - TAX NDERRIMI DESTINIMI I TOKES	70,150.00	63,201.75	90.10	-9.90
50026 - TAX PER LEGALIZIMIN E OBJEKTE.	24,090.22	24,687.43	102.48	2.48
50045 - TAX PER LEJE MJEDISORE	31,188.53	18,221.61	58.42	-41.58
20010 - TAX PER DEMOLIM (rrenimi i objekteve)	1,843.19	1,580.65	85.76	-14.24
18163 - INFRASTRUKTURA PUBLIKE				
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	2,220.00	18,316.30	825.06	725.06
50406 - PRONA PUB.PER TREG.TE HAPUR	34,294.52	31,921.36	93.08	-6.92
50103- LARGIMI DHE DEPONIMI I AUTOMJETEVE	0.00	0.00		
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	0.00	0.00		
50029- TAX PER USHTRIMIN E VEPRIMTARIS				
85003 - SHËRBIMET KULTURORE-LIPJAN				
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE (RHIVA)	329.00	301.00	91.49	-8.51
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	0.00		
GJITHESEJT I:	2,053,637.21	2,033,751.37	99.03	-0.97
92250 - ARSIMI PARAFI & QERDHJA-LIPJAN	51,633.00	60,085.50	116.37	16.37
73200 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETESIA	46,164.00	49,209.50	106.60	6.60
50403 - TE HYRAT NGA SHITJA E MALLRAVE (PARTICIPIM) A.G.	7,395.00	15,678.10	212.01	112.01
50405 - SHFRYTEZIMI I PRONES PUBLIKE	0.00	0.00		
50409- SHKOLLA E MESME ULIPIANA	86.00	100.00	116.28	16.28
GJITHESEJT II:	2,158,915.21	2,158,824.47	100.00	0.00
GJOBAT E TRAFIKUT	329,691.50	404,330.70	122.64	22.64
GJOBAT E GJYKATES	49,670.00	46,400.00	93.42	-6.58
AGJENCIONI I PYJEVE	908.12	889.26	97.92	-2.08
GJITHESEJT III:	2,539,184.83	2,610,444.43	102.81	2.81

Donacionet gjatë këtij viti kanë qenë 554,499.32 €

SEKTORI I THESARIT

Gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin e Thesarit janë pranuar dhe janë kryer gjithsejtë: 4,669 lëndë në vlerë 7,293,817.74 €.

Ecuria e shpenzimeve në bazë të kategorive ekonomike, duke përjashtuar kategorinë ekonomike të pagave dhe medijëve pasi që këto lëndë procesohen në Ministrinë e Financave, duket kështu:

Kategorit Ekonomike	Nr. I Lëndëve	Shuma	%
Mallra e Shërbime	2,249	2,097,959.22	28.76%
Komunali	335	335,552.09	4.60%
Subvencione dhe Transfere	856	893,178.68	12.25%
Investime Kapitale	126	3,967,127.75	54.39%
Totali :	4,669	7,293,817.74	100.00

Gjatë kësaj periudhe kohore janë ekzekutuar :

- 187 lëndë janë të vitit 2021 në vlerë 476,965.22 € 6.54%
- 4,482 lëndë janë të vitit 2022 në vlerë 6,816,852.52 € 93.46%

Kurse në Departamentin e Thesarit të M.F. janë ekzekutuar 19 lëndë në shumë 232,762.82 €. ose shprehur në përqindje 3.19% të shpenzimeve të tërësishme.

Zyrtarja e Arkivës ka pranuar, skanuar dhe arkivuar 4,669 lëndë, po ashtu sipas kërkesave të paraqitura ka skanuar dhe dorëzuar 419 lëndë.

Ekzekutimi i pagesave nga Thesari -MFT 2022

Mjetet financiare nga janë marrur-Vendim gjyqësor	Kodi ekon.	Shuma	Qellimi i pagesës -Vendim gjyqësor
Nga kategoria ekonomike paga dhe medijtje - 16303 Administrata	11900	27,788.57	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
Nga kategoria ekonomike paga dhe medijtje - 73200 Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor	11900	1,209.00	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
Nga kategoria ekonomike paga dhe medijtje - 93060 Arsimi Fillor	11900	92,631.16	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
Subvencione dhe transfere	22300	2,808.19	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
Shpenzime komunale	13260	17,371.46	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
Bashkfinancim me donator	34000	13,146.85	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
89962-Rrjeti i ujësjellsit për fshatin Akllap	34000	14,921.06	Pagesa për vendime gjyqësore-paga
89962-Rrjeti i ujësjellsit për fshatin Akllap	34000	23,374.64	Pagesa-Ndërtimi i Parqeve dhe Hapsirave Publike në fshatrat e Komunes së Lipjanit
89962-Rrjeti i ujësjellsit për fshatin Akllap	34000	5,188.05	Pagesa-Ndërtimi i shetitores te Pishat në Gadime,
50786 Ndërtimi i shetitores te pishat në Gadime	34000	7,237.11	Pagesa-Metete e dedikuara për shpronësim
49399 - Vazhdimi i ndërtimit të sheshit Adem Jashari-pjesa e II	34000	60,000.00	Pagesa-Hartimi i projekteve
51314-Zgjerimi i ndriqimit publik në lagjet e fshatit Magure dhe në hyrje të fshatit Sllovi	34000	13,691.97	Pagesa-Hartimi i projekteve
51409-Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Blinajë-Leletiq	34000	60,000.00	Pagesa - Hartimi i projekteve
Nga kategoria mallra dhe shërbime	14410	4,430.84	Pagesa - në kategorinë mallra dhe shërbime
Nga kategoria mallra dhe shërbime	14410	11,042.65	Pagesë me vendim gjyqësor, rrenimi i objektit
Gjithësejt:		354,841.55	

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Viti 2022, në sektorin e Tatimit në Pronë llogaritet vit shumë i suksesshëm, pasi që edhe këtë vit kemi tejkaluar planifikimin e të hyrave për 2.96%, si dhe në krahasim me vitin 2021 kemi tejkaluar për 11.32%.

Në fillimi të vitit, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, gjegjësisht Departamentin e Tatimit në Pronë kemi nxjerre dhe printuar me kohë faturat e tatimit në pronë për vitin 2022. Faturat e tatimit në pronë për vitin 2022, janë shpërndarë nga PTK-se, ku nga raporti i PTK-së që kemi pranuar, fatura të shpërndara nga PTK kanë qenë 14,079. Në zyrën e tatimit në pronë, sipas kërkesave të tatimpaguesëve, dhe për nevojat të tatimpaguesëve, për periudhën janar-dhjetor, janë printuar 43,380 fatura.

Gjatë periudhës janar - dhjetor i kemi pranuar 36 ankesa të tatimpaguesëve të cilët nuk janë pajtuar me ngarkesën e tatimit në pronë. Nga këto ankesa, 27 ankesa janë aprovuar në favor të tatimpaguesëve, ndërsa 9 ankesa janë refuzuar si të pa bazuara, të gjitha ankesat janë shqyrtuar mbreda afatit ligjor. Ekipi anketues ka përmbushur në tersi planin e ri anketimeve, sipas planit nga numri i përgjithshëm i pronave 19,950, ka qenë obligative të ri anketohen 20 %, pra 3990 prona, ndërsa sipas rezultatit përfundimtar janë ri anketuar gjithsejtë 4061 prona.

Numri i regjistrimit të pronave të reja gjatë periudhës janar - dhjetor 2022, janë regjistruar 784 prona. Janë modifikuar 2019 prona, prona të reja afariste janë regjistruar gjithsejtë 143 prona, ndërsa prona të cilët me rastin e ri anketimit nuk kanë pasur ndryshime janë 1115 prona.

Gjatë periudhës janar – dhjetor kemi edhe kërkesa të tjera të cilat janë prashtruar nga tatimpaguesit në zyrën e tatimit në pronë si për shembull: kërkesë për ndërrim të pronarit, ndërtime të pronave të reja, apo rrënim të pronave ekzistuese, ku këto kërkesa tatimpaguesit i kanë parashtruar në zyrën e tatimit në pronë si “Kërkesa për korrigjim” ku ekipi i

zyrtarëve për vlerësim të pronave të paluajtshme ka dalë në teren dhe ka bërë verifikimin atyre kërkesave. Numri i kërkesave të tilla është 585 kërkesa, ku 545 janë aprovuar, 23 kërkesa janë refuzuar nga ekipi anketues, 20 kërkesa janë në pritje, të cilat pritet të shqyrtohen në fillim të vitit 2023.

Numri i kërkesave të aprovuara të tatimpaguesve për të hyrë në marrveshje për pagesën e tatimit me këste është 157. Certifikata të lëshuara me qëllim të kryerjes së shërbimeve në kataster dhe urbanizëm, për subvencione në bujqësi si dhe vërtetime për humbje të nënshtesisë 9674.

Vërejtje dhe njoftime përfundimtare të tatimpaguesve për vonesën e kryerjes së obligimeve në tatim në pronë, janë dërguar 9 vërejtje dhe 91 njoftime përfundimtare.

Sipas evidencës që e mbanë zyra e tatimit të pronë, inkasimi i të hyrave nga tatimi në pronë gjatë periudhës janar-dhjetor është në vlerë prej 1,237,276.81€

DISKUTIME PUBLIKE

Dëgjimet Publike për Planifikim të Buxhetit 2023-2025

Në vitin që lam pas janë mbajtur 22 dëgjime buxhetore për KAB-in si dhe lidhur me projeksionet buxhetore për vitet 2023-2025 dhe janë përfshirë Drejtoratet, Kuvendi, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, si dhe janë organizuar takime në lokalitete të ndryshme me strukturat dhe grupet tjera (Shoqëri civile, OJQ të ndryshme, shoqata, fermerë, klube sportive si dhe qytetarë tjerë).

Njoftimi për dëgjimet publike është shpërndarë me kohë në çdo lokalitet që është ftuar për dëgjime, në institucionet publike dhe në ëebfaqe të Komunës së Lipjanit.

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë vitit 2022, në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim janë realizuar detyra dhe obligime, si dhe aktivitete që dalin nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, ligjet tjera sektoriale, udhëzimet, urdhëresat, statuti dhe rregulloret tjera komunale, si dhe obligime të tjera nga e drejta pozitive në përgjithësi, duke përcjellur planin e punës dhe objektivat e drejtoratit për vitin 2022.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Projekti "Ndërtimi i Zonës/Parku Industrial në Qylagë", sipas MTI-së, ka vazhduar të implementohet edhe pse në hapa jo shumë të shpejtë. Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi për furnizim me energji elektrike në mes të Komunës së Lipjanit dhe KEDS si dhe memorandum i në mes të Komunës dhe Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, priten vetëm fillimet e implemetimit të këtyre memorandumeve të cilat janë nënshkruar vitin që lam pas.

Kemi dërguar shkresë në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për vazhdimin e bashkëfinancimit për Zonën Ekonomike në Qylagë, me ç'rast është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në mes MINT dhe Komunës së Lipjanit për vazhdimin e financimit në këtë Zonë Ekonomike, në fundin e vitit 2022 është bërë edhe përzgjedhja e operatorit për paramasën e dërguar nga departamenti ynë e cila procedurë udhëhiqet nga KIESA.

Kemi punuar ngushtë me përfaqësuesit e Zyrës së EU-së në Kosovë, UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës dhe rreth projektit i cili do të investohet në Janjevë për zhvillim të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Projekti është në vlerë rreth 3.4 milion euro. Vlenë të theksohet se Memorandumi Bashkëpunimit në mes të Ministrisë së Kulturës dhe UNDP-së, është nënshkruar në vlerë prej 1.4 milion euro, i cili memorandum i paraprinë investimeve në Janjevë ku ne si komunë kemi punuar ngushtë me përfaqësuesit e Zyrës së EU-së në Kosovë, UNDP-së dhe Ministrisë së Kulturës.

Nga informatat që kemi në bashkëpunim me UNDP-në, pritet nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në vlerë prej 2 milion euro nga fondet e IPA III, rreth këtij projekti për zhvillim të turizmit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Vlera e projektit në total është 3.4 milion euro dhe sipas Zyrës së EU-së në Kosovë, në fundin e vitit 2022 është filluar të intervenohet në 4 shtëpi si dhe është hartuar projekti për tërë qytezën e Janjevës për kanalizim dhe ujësjellës nga kompania "Hidro Projekti" e kontraktuar në kuadër të projektit nga UNDP. Po ashtu janë mbajtur dy takime të Bordit të këtij projekti ku ne si institucion lokal jemi pjesë e këtij, njëherit kemi tregu gatishmëri dhe mbështetje të vazhdueshme

për këtë projekt në implementimin e objektivave që kanë fokus aktivitetin e institucionit tonë lokal për këtë projekt. Projekti në fjalë do të vazhdojë të implementohet edhe përgjatë vitit 2023.

Gjatë vitit 2022, është vazhduar të punohet me përfaqësuesit e Bankës Botërore dhe IFC-së rreth projektit "Përmirësimi i Klimës së Investimeve II përmes thjeshtimit të procedurave administrative", ku zyrtarë nga departamenti ynë kanë qenë pjesëmarrës në punëtorinë e mbajtur nga operatori i cili ka krijuar këtë platformë "Cactus".

Sipas vendimeve paraprake të kuvendit komunal të Lipjanit dhe vendimet mbi formimin e komisioneve për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale, komisionet e formuara kanë punuar, aktualisht janë në procedurë të shqyrtimit të aplikacioneve nga ofertuesit për Zonën Ekonomikë në Qylagë faza e I-rë, kjo fazë përfshin sipërfaqe prej 6.83ha, të ndara në 7 parcela, konkursi për këtë fazë të vendosjes së bizneseve është hartuar nga departamenti ynë në pajtim me legjislacionet në fuqi.

Është nënshkruar memorandum bashkëpunimi mes Komunës së Lipjanit dhe organizatës ASB dhe Preda Plus për bashkëfinancimin e granteve në kuadër të projektit "Fuqizimi i Gruas në Zhvillim të Ndërmarrësisë", me ç'rast departamenti ynë ka udhëhequr këtë proces si dhe kemi qenë bashkëfinancues për 7 grante të përfituara nga gratë e lokalitetit të Lipjanit.

Në këtë vit është bërë arsyetimi në Këshillin Ndërmarrës për themelimin e ndërmarrjes publike "ULPIANA" SH.A. si dhe kemi dorëzuar në Ministrinë e Ekonomisë respektivisht në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike planin e detajuar duke ju përgjigjur kërkesës për të kompletuar arsyetimin e themelimit të kësaj ndërmarrjeje me ç'rast pritet që funksionalizimi i saj të bëhet gjatë vitit 2023.

Zyra për Integritet Evropian ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Përbushjen e Obligimeve të Komunave nga Agjenda Evropiane ku është paraqitur në detaje e gjithë puna e Komunës për secilin sektor. Në këtë raport gjithashtu të gjithë sektorët e Komunës kanë paraqitur të arriturat në përbushjen e rekomandimeve të dala nga agjenda evropiane. Zyrtarja për integritet evropian po ashtu ka përgatitur raportin për monitorim dhe zbatim të planit të integritetit.

Kemi raportuar në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal mbi implementimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2019-2023, si dhe me kërkesë të departamentit tonë është formuar komisioni i cili ka hartuar raportin e implementimit të strategjisë.

Janë zhvilluar aktivitete në fushën e turizmit, kemi nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Unionin e Turizmit të Kosovës, janë krijuar materiale për promovim turizmi, si dhe është duke u punuar në krijimin e një platforme turizmi për vitin vijues.

Është hartuar rregullore e brendshme për ndarjen e përgjegjësi dhe menaxhimin për arkëtimin e të hyrave komunale.

Janë plotësuar të gjitha rekomandimet nga auditorët për departamentin ekonomi dhe zhvillim.

Duke ditur se të gjitha investimet infrastrukturore si rruga deri në Blinajë me ndriqim publik, rrugët brenda fshatit Blinajë, trotuari dhe investime brenda parkut kanë përfunduar, jemi angazhuar për rritjen e bashkëpunimit në mes Komunës së Lipjanit dhe Ministrive relevante me qëllim që të mundësohet shpejt hapja e Blinajës për vizitorë.

Angazhimin po ashtu do ta vazhdojmë edhe për rishikim të politikave shtetërore rreth menaxhimit dhe promovimit të Shpellës së Gadimes ngase kjo do të sillte shtim të të hyrave, zhvillim të veprimtarive ekonomike që përbëjnë ekonominë turistike përfshirë: hotelerinë, transportin, tregtinë, institucionet kulturore, rritjen e punësimit, standardit jetësor, investimet, zhvillimin e viseve të pazhvilluara.

Gjatë kësaj periudhe kemi realizuar takime me përfaqësuesit e organizatës Kosovo – Eomen4Eomen, po ashtu kemi mbajtur takime të ndryshme me donatorë dhe organizata ndërkombëtare e vendore si: Banka Botërore, UNDP, ASB, Preda Plus, USAID, Help Kosova, Sëiss Contact dhe shumë organizata tjera partnere rreth zhvillimit ekonomik në sektorë të ndryshëm, si dhe takime me përfaqësues të bizneseve.

STATISTIKAT

Shërbimet ndaj bizneseve dhe bizneset e regjistruara.

Bazuar në të dhënat e zyrës për regjistrim të bizneseve në Lipjan, numri i bizneseve aktive në Komunën e Lipjanit është 4012. Numri i bizneseve të regjistruara në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2022 është 308 biznese ndërsa numri i bizneseve të shuara është 21. Gjithsej gjatë kësaj periudhe kohore zyra për regjistrim të bizneseve ka regjistruar në protokol 823 shërbime për biznese.

Sfidë në vazhdimësi ka qenë situata pas pandemike dhe inflacioni, kjo ka pas impakt negativ në zhvillimin e mëtutjeshëm të bizneseve dhe të mirëqenies së qytetarëve.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1.	Pagesa bizneseve për ndryshime	407	
2.	Biznese të reja të regjistruara	308	
3.	Ndrrim i Qertifikatave të reja	62	
5.	Kërkesë për ndryshim adreses	42	
6.	Shtim i njësisë biznesit	12	
7.	Vërtetim që posedon biznes	143	
8.	Shuarje të biznesit	21 biznese	5 Njësi të shuara
9.	Shtim i aktivitetit të biznesit	25	
10.	Informatat e bizneseve	122	
11.	Ndrrim i pronarit	34	
12.	Ndryshim emrit të biznesit	21	
13.	Kërkesë për ndryshim kapitali	16	
14.	Ndrrim i tipit biznesit	13	

Lëndët e regjistrimit të bizneseve të cilat janë të evidentuara sipas numrit rendor në librin e protokolit nga data 19.06.2012 deri më 18.11.2022 sipas numrit të folderave të cilët janë të arkivuara në arkivën e re të administratës komunale, totali 124 foldera me gjithsej 6200 lëndë të regjistruara.

Të hyrat nga qiraja

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka informuar Sekorin Pronësores-Juridik për pagesën e qirave dhe obligimet bazuar në kontratat e lidhura për lokalet dhe pronat tjera komunale, sa i përket obligimeve që kanë patur shfrytëzuesit e objekteve të komunës së Lipjanit, ndërsa sipas vendimit të kuvendit komunal ngarkesat për shfrytëzuesit e banesave me raste sociale janë falur për shkak të pandemisë Covid-19 dhe gjendjes së rënduar financiare.

DREJTORATI PËR PLANIFIKIM, URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2022 ka kryer detyrat e caktuara me përgjegjësi dhe në përputhje me Planin vjetor të punës. Fokusi themelor i Drejtoratit ishte në fushën e planifikimit hapësinor, hartimit të dokumentacionit planor për projektet infrastrukturore dhe për shqyrtimin e kërkesave të palëve për çështje të ndryshme urbane.

Në kuadër të këtyre angazhimeve themelore, duhet veçuar:

- Shpalljen e nëntë (9) objekteve si “monumente të natyrës” dhe vendosja e shenjave informuese për mbrojtjen e tyre;
- Zhvillimi i procedurave dhe fillimi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për periudhën e ardhshme tetë (8) vjeçare 2023-2031;
- Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për periudhën 2023 -2027;
- Hartimi dhe miratimi i Raportit vjetor për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës si dhe njoftimi i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturs;
- Shqyrtimi i 671 lëndëve, duke përfshirë edhe 104 lëndë në procedurën e trajtimit të ndërtimeve pa leje (legalizim) nga gjithsej 809 lëndë të natyrave të ndryshme.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE DHE AKTIVITETEVE TË CAKTUARA

Bazuar në Planin e punës së DPUMM për vitin 2022, veprimtaria e DPUMM ishte e orientuar në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat ligjore nga fusha e planifikimit, ndërtimit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Aktivitetet e realizuara për periudhën raportuese

- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve dhe informacioneve të tjera për MMPHI, ASK, DEMOS, UNDP, OSBE dhe plotësimi i Raportit për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda evropiane.

- Aktivitetet administrative në kuadër të procesit të shpronësimit të pronave për realizimin e projekteve me interes publik;

- Aktivitetet në kuadër të "Projektit për qeverisje të mirë dhe demokratike" – Këshilli i Evropës,

DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga palët, si dhe ka kryer aktivitete të tjera tëaktuara.

Nga viti 2021 në vitin raportues janë bartur 128 lëndë, kurse gjatë vitit 2022 janë pranuar edhe 681 lëndë të natyrave të ndryshme. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve prej 809, janë shqyrtuar 671 lëndë, kurse 138 barten në vitin 2023, prej tyre 108 në proces të legalizimit.

Prej 681 lëndëve të pranura në vitin 2022, 564 lëndë ishin nga fusha urbane, kurse të bartura nga viti 2021 ishin 31 lëndë të natyrës urbane. Nga numri i përgjithshëm i lëndëve në fushën urbane prej 595 kërkesave janë shqyrtuar gjithsejt 565 lëndë, përkatësisht 94.95% e tyre, ndërsa 30 lëndë janë bartur në vitin 2023. Mirëpo nga ky numër i kërkesave të shqyrtuara, duhet pasur parasysh faktin se 12 prej tyre janë pezulluar, kurse 60 kërkesa të tjera janë bartur në sektor të tjerë. Nga kjo analizë del se numri real i kërkesave të shqyrtuara në fushën urbane është 492 kërkesa. Nga ky numër 188 kërkesa kanë të bëjnë me kushte ndërtimore (124) dhe me leje ndërtimore (64). Kërkesat për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore konsistojnë me shqyrtim tejet analitik dhe me njohje të lartë profesionale, prandaj trajtimi i tyre merr kohë, sidomos ato të kategorisë së dytë.

Aktivitet i veçantë i zhvilluar gjatë vitit 2022 dhe atë për herë të parë, ishte hartimi dhe miratimi i Raportit vjetor për Monitorimin e Zbatimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK) për periudhën një vjeçare. Sipas Ligjit për Planifikimin Hapësinor, ky Raport është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe pastaj iu ka dërguar MMPHI për njoftim. Në Raport është dhënë vlerësimi për nivelin e zbatueshmërisë së HZK dhe janë prezantuar sfidat që e kanë përcjellur DPUMM për zbatueshmërinë e këtij dokumenti planor.

Në këtë periudhë raportuese kemi zhvilluar edhe aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi. Gjatë vitit 2022 janë pranuar gjithsejt 117 lëndë, kurse të bartura nga viti 2021 ishin 97 lëndë. Nga numri i përgjithshëm prej 214 lëndëve, janë shqyrtuar gjithsejt 104 lëndë, përkatësisht 48.59% e tyre, 2 lëndë janë pezulluar, ndërsa 108 janë bartur në vitin 2023.

Nr.	Llojet e kërkesave	Kërkesa të pranura në 2022	Kërkesa të bartura nga 2021	Të pezulluara	Miratuara	Refuzuara	Bartur në sekt. tjerë	Në procedurë
1.	Kushte ndërtimore	117	18	6	60	64	1	4
2.	Leje ndërtimi	72	4	3	39	25	-	8
3.	Leje renovimi, apo vendosje e objekteve të përkohshme	22			10	9	1	2
4.	Leje rrënimi	5			4	1		-
5.	Certifikatë perdorimi	8	1		4	2		3
6.	LMK	7	1		4			2
7.	Emërtim rruge, adresa	30					30	
8.	Informacione urbane	69			67	1		1
9.	Certifikatë legalizimi/ leje legalizimi	117	97	2	68	22		108
	Në listë të pritjes				14			
10.	Kërkesa të tjera	234	8	3	184	17	28	10
11.	Gjithsejtë	681	128	14	454	141	60	138

Aktivitetet tjera të realizuara

Procedimi në Kuvend i Vendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK); Hartimi i detyrës projektuese për PZHK dhe menaxhimi aktivitetëve të para në procesin e hartimit të PZHK. Në kuadër të këtij procesi deri më tani janë zhvilluar këto aktivitete:

Organizimi i takimit të parë të hapur, në të cilin është bërë shënimi i fillimit të punimeve në hartimin e PZHK dhe është prezantuar roli i pjesëmarrësve në këtë proces.

Në takimin e dytë është prezantuar Plani i veprimit (kohor) për hartimin e PZHK-së dhe është prezantuar përgjegjësia e subjekteve pjesëmarrëse për grumbullimin e të dhënave për fazën e parë të projektit – profilin e Komunës.

Janë organizuar katër (4) tryeza në fusha tematike si: Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe turizëm; Arsim dhe shëndetësi; Infrastrukturë dhe shërbime publike dhe Planifikim hapësinor, banim, mjedis dhe kulturë.

Është organizuar një punëtori dy ditore për “Profilin e Komunës” si dhe është përgatitur materiali dhe është bërë njoftimi për hapjen e diskutimit publik për Profilin e Komunës.

Hartimi i konceptit të planifikimit hapësinor për zonën komerciale në “Qylagë”;

Hartimi i konceptit të planifikimit hapësinor për zonën ekonomike në Konjuh;

Hartimi i detyrës projektuese për parkun qendror të qytetit dhe për parkingjet nëntokësore;

Hartimi i detyrës projektuese për nënkalimin në rrugën “Lidhja e Prizrenit” dhe vazhdimin e e ndërtimit të sheshit “Adem Jashari”;

Hartimi i detyrave projektuese për projektet e ndryshme infrastrukturore. Në këtë kontekst DPUMM në bashkëpunim me drejtoratet përkatëse dhe kompaninë projektuese ka finalizuar gjithsejtë 47 projekte komunale të fushave si:

- Infrastrukturë rrugore, trotuare dhe ndriçim publik -17 projekte;
- Nga fusha e mjedisit - 6 projekte;
- Infrastrukturë shoqërore - 24 projekte, të cilat janë dorëzuar dhe proceduar për zbatim pranë Drejtorateve përkatëse.

Nr.	Aktiviteti	Emri i projektit	Lokacioni	Të arriturat
A. DOKUMENTE PLANORE				
1.	Procesi i hartimit të PZHK	Plani Zhvillimor i Komunes	Komuna - Lipjan	Vendimi per hartimin e PZHK, lidhja e kontratës dhe hartimi i Profilit të Komunës
B. INFRASTRUKTURË RRUGORE				
1.	Hartimi i dokumentacionit teknik	Rikonstruim i rrugëve “Beqir Duriqi” dhe “Vehbi Kozhani” etj	Ribar i Madh	Finalizuar
2.		Rikonstruim i rrugëve	Poturoc, Dobrajë e Madhe	//
3.		Ndriçimi publik	Teqe	//
4.		Ndriçimi publik	Mirenë	//
5.		Trotuari me ndriçim publik	Qallapek	//
6.		Trotuari me ndriçim publik	Gllavicë- Marevc	//
7.		Trotuari me ndriçim publik	Akllap	//
8.		Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshtrave	Silovi, Gadime Smallushë Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush	//
9.		Rikonstrumi i rruges “Agim Bllaca”	Ribar i Vogël	//
10.		Asfaltimi i rrugës “Mbijetesa”	Hallaq Madh	//
C. INFRASTRUKTURË TEKNIKE - MJEDIS				
1.	Hartimi i dokumentacionit tek.	Shtrati i lumit ne Gadime- vazhdimi	Gadime e Ulët	Finalizuar
2.		Shtigjet e ecjes ne Gadime Faza II	Gadime	“
3.		Shtrati i lumit	Ribar i Madh	“
4.		Shtrati i lumit	Gllagovc	“
5.		Shtrati i lumit	Smallushë	“
6.		Rregullimi i HHP	Lumi “Sitnica” Lipjan	“
D. INFRASTRUKURË SHOQËRORE				
1.	Hartimi i dokumentacionit tek.	Renovimet në shkollat – paralelet e ndara në vendbanimet e caktuara	Jeta e Re, Konjuh, Vërshevc, Resinoc, Llugë, Gadime e Ulët, Vrellë e Goleshit, Medvec, Vrellë e Gadimes, Pojatë, Mirenë	Finalizuar

		dhe Zllakuqan.	
2.	Ndërtimi i Qendres urgjente dhe QKMF-së	Lipjan	Në proces
3.	Ndërtimi i Qendres kulturore "Tahir Sinani"	Lipjan	Në proces
4.	Renovimi i QMF	Shalë	Finalizuar
5.	Institucione parashkollore	Shalë Ribar i Madh dhe Rufc i Ri	Finalizuar
6.	Kënde të lojërave për fëmijë në kuadër të IP	Lipjan, Slllovi, Rufc i Ri dhe Gadime	"
7.	Parqet dhe lojrat për fëmijë në kuadër të shkollave.	Në shkollat e disa fshatrave	"
8.	Ndërtimi i Shkollës	Ribar i Madh	"

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë kryer disa aktivitete tejet të rëndësishme si:

Hartimi dhe miratimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për periudhën 2023 – 2027. Në procesin e hartimit të këtij Plani është zhvilluar shqyrtimi publik 30 ditor sipas legjislacionit në fuqi, si dhe është zhvilluar anketimi i një grupi të qytetarëve lidhur me problemet mjedisore dhe për prioritetet e zgjidhjes së tyre. Ky Plan është miratuar në Kuvendin e Komunës me 22 dhjetor 2022. Pjesë e këtij dokumenti është Plani i veprimit me të cilin janë përcaktuar prioritetet për zgjidhjen e problemeve mjedisore brenda periudhës së ardhshme 5 vjeçare;

Shpallja nën mbrojtje institucionale e nëntë (9) objekteve si "monumente të natyrës" dhe vendosja e shenjave informuese. Lidhur me këtë aktivitet është mbajtur konsultimi publik sipas legjislacionit në fuqi.

Shënimi i disa ditëve ndërkombëtare për mbrojtjen e mjedisit si: "Dita ndërkombëtare e Tokës", "Dita ndërkombëtare e ndryshimeve klimatike" etj.

	Aktiviteti	Lloji	Lokacioni	Të arriturat
A	PJESËMARRJA NE KOMISIONE DHE GRUPE PUNUESE			
1.	Aktivitetet e DPUMM në kuadër të Komisioneve, Grupeve Punuese dhe në aktivitete të tjera.	Plani lokal për menaxhimin e mbeturinave	Lipjan	Draft Plani
2.		Sistemi i Menaxhimit të shërbimeve të Përformances Komunale 2021	Prishtinë	Finalizuar
3.		Programi 3 vjeçar i banimit	Lipjan	Miratuar ne KK
4.		Plani Lokal i Veprimit në Mjedis	Lipjan	Miratuar me Vendimin e KK
5.		Menaxhimi i projektit – Ndërtimi i objektit të Administratës Komunale	Lipjan	Finalizuar
6.		Menaxhimi i projektit – Palestra sportive	Lipjan	Në proces
7.		Menaxhimi i projektit – Stadioni Faza II	Lipjan	Në proces
8.		Menaxhimi i projektit – shenjëzimi i monumenteve të natyrës	Lipjan	Finalizuar
9.		Plani për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit.	Lipjan	Miratuar me Vendimin e KK
10.		Verifikimi, Arkivimi dhe asgjësimi i lëndëve në arkivin komunal	Lipjan	Finalizuar
11.		Pjesëmarrje në komisionin për pranim teknik të objektit të Administratës komunale	Lipjan	"
12.		Takim senzibilizues dhe informues me nxënësit e shkollave fillore me rastin e 22 Majit "Dita ndërkombëtare e tokës"	Lipjan	"
13.		Pjesëmarrje në Komision për shqyrtimin e kërkesave për LMK	Lipjan	Në vazhdimësi
14.		Pjesëmarrje në Komision për legalizim të objekteve të kategorisë së II-të	Lipjan	Shuarja e këtij Komisioni
15.		Shqyrtimi i kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore	Lipjan	Në proces
16.		Vlerësimi i tenderit/ ofertat për aktivitetin e prokurimit – hartimi i projekteve - 3 lote	Lipjan	Në proces
17.		Pjesëmarrje në Takimin konsultativ për zgjerimin e terminalit në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës	MMPHI	Në proces
18.		Pjesëmarrje në grupin punues për identifikimin, vlerësimin dhe përcaktimin e veprimeve ndaj rrezikut në procesin e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve nga drejtoratet përkatëse të Komunës	Lipjan	Finalizuar
19.		Pjesëmarrje në takimet e Kolegjiumit të Planifikimit Hapësinor	ASK Prishtinë	Në vazhdimësi
20.		Pjesëmarrje në takimin konsultativ "Sistemi i adresave"	AKK	Finalizuar

KRYERJA E DETYRAVE, KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

Aktivitetet e caktuara janë realizuar në një masë të konsiderueshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Megjithatë, edhe më tutje numri i lëndëve të bartura është tejte i lartë, sidomos i atyre në procesin e legalizimit.

Në kryerjen e aktiviteteve të caktuara, DPUMM ka komunikuar me palët sipas interesimit të tyre. Puna e DPUMM është e hapur dhe aktet e duhura janë publikuar në faqen zyrtare të internetit. Në faqen zyrtare të internetit janë publikuar edhe format e kërkesave të nevojshme që parashtrihen nga palët dhe informacione të tjera nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit. Po ashtu janë të publikuara edhe aktet përkatëse nënligjore që ndërlidhen me planifikimin urban dhe çështjet e ndërtimeve.

Cilësia e kryerjes së detyrave ishte relativisht e lartë. Viti 2022 është përcjellur me vështirësi/sfida të natyrave të ndryshme, të cilat në një masë e kanë ndikuar realizimin e aktiviteteve.

Puna në kuadër të DPUMM është mjaft specifike dhe konsiston me një përgjegjësi të lartë në vendimmarrje sidomos për zbatimin e dokumenteve planore dhe shqyrtimit të kërkesave të palëve

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë – Zyra komunale Kadastrale e Komunës së Lipjanit, ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare .

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë kësaj periudhe objektivat tona kryesore kanë qenë kryesisht në ofrimin e shërbimeve profesionale, avancimi profesional i stafit duke mbajtur trajnime, pastaj vazhdimin e bashkëpunimit me Agjensionin Kadastral të Kosovës dhe organizatat tjera në përfitimin e përkrahjes së tyre në realizimin e projekteve të caktuara.

Rritja e të hyrave gjithashtu ka qenë synim i yni. Ndërkohë objektiv tjetër është edhe kthimi i origjinaleve e manualeve dhe regjistrave kadastrale të marrura nga pushteti i atëhershëm, si dhe azhurimi i të dhënave në modelin digjital, edhe pse në këtë drejtim nuk ka asnjë rezultat konkret, sepse kjo varet nga niveli i institucioneve qendrore.

Në periudhën janar – dhjetor kemi shqyrtuar të gjitha kërkesat që kanë qenë kompetencë e drejtoratit tone, kërkesa këto të pranuar në të dy sektorët, sektorin e gjeodezisë dhe të kadastrit.

Në vazhdimësi jemi angazhuar për realizimin e objektivave: Arritja e një transparence më të lartë, Projekti i Rindërtimit të Kadastrit, Shpejtimi i Azhurimit të Lëndëve dhe promovimi i punës dhe fitimi i përkrahjes nga Institucionet dhe Organizatat e ndryshme.

STATISTIKAT

Sektori i Gjeodezisë:

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuar	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Gjithsej
644	6	650	647	3	-	650

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT NUK ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Kopje Plani	1399
2	Konsultime me palë	302
3	Marrje e produkteve	565

Në tabelën e poshtë shënuar janë paraqitur punët e kryera ne formën tabelare, nga të gjitha punët e kryera gjatë vitit 2022.

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. I LËNDËVE	SHËNIM (vërejtje)
1	Ndarje të parcelave (regjistrim i ndarjeve)	644	Në zyrë
2	Punë për shërbimin pronsor- juridik	15	Në terren
3	Ri rregullim kufiri	7	Në zyrë
4	Ndërrimi kultures së parcelave	5	Në zyrë
5	Matje e objekteve	6	Në zyrë
8	Bashkim i parcelave	11	Në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndërtesave	13	Në terren

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur llojet e punët e kryera në vitin 2022.

Muaji	Regj.ndar	Marrje e produk.	Regj. i pjesve te ndërtesave	Bashkim i parcelave	Ndrrim i kultures	Matja e ndërtesave	Rirreg. kufiri
Janar	24	22	-	2	-	-	-
Shkurt	60	53	1	1	1	-	-
Mars	45	42	1	1	-	-	1
Prill	53	50	1	1	-	-	-
Maj	40	38	2	1	1	-	-
Qershor	61	57	1	1	-	-	1
Korrik	50	46	-	-	-	-	1
Gusht	81	78	1	1	1	3	-
Shtator	9	6	1	-	1	-	-
Tetor	82	79	2	2	-	-	-
Nentor	54	51	1	1	1	-	1
Dhjetor	49	43	2	-	-	-	-

Sektori Kadastrit

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë vitit 2022 janë të prezantuara në formë tabelare

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr. i kërkesave të pranuar gjatë këtij gjashtë muaji	Nr. i kërkesave nga viti i kaluar	Të pezulluara	Të miratuara (kryera)	Të refuzuara	Në procedurë
1	Bartje pronësie	1833	0	-	1778	5	50
2	Regjistrim të Hipotekave	228	0	0	202	2	24
3	Të tjera	238	0	0	237	2	2
4	Çertifikata të Pronësisë	4028	0	0	4028	0	0
5	Vërtetime për raste sociale	3694	0	0	3694	0	0
6	Gjithsej:	10021			9936	9	76

Gjatë vitit 2022 sektori i Kadastrit ka regjistruar prona pa pagesë 418 çifte bashkëshortore sipas Udhëzimit Administrativ për Masa të Veçanta. Gjatë këtij viti ka pasur rënie të numrit të lëshimit të çertifikatave pronsore në krahasim me vitin e kaluar për arsye se nuk kanë aplikuar për subvencione.

Bashkëpunimet

Gjatë periudhës së vitit 2022 kemi pasur bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; me zyrtarët e agjensionit kadastral kemi mbajtur takime të rregullta për avancimin e punës profesionale në Drejtorat. Gjatë këtij viti kemi mbajtur takime të rregullta edhe me zyrtar të organizatave të ndryshme.

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 03.01.2022 deri 31.12.2022, drejtorati ka kryer aktivitetet të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
130	130	0	0	0

Buxheti i Departamentit të infrastrukturës;

Meqenëse departamenti i infrastrukturës është departament i themeluar me ndryshimet statutare të komunës të datës 24.12.2021 ka funksionuar me buxhet të vitit 2022 i aprovuar për departamentin e Shërbimeve Publike. Prandaj ne po paraqesim vetëm buxhetin e investimeve kapitale të parapara për vitin 2022, për të cilin është përgjegjës departamenti ynë të menagjoj.

Gjatë kësaj periudhe Janar – Dhjetor 2022, Drejtoria për Infrastrukturë ka përgatitur dhe proceduar për publikim të gjitha projektet e planifikuara në kuader të drejtoratit, që gjithësej kanë qenë **27** Projekte, si dhe ka përgaditur paramasat dhe paralogaritë në bashkëpunim me shtëpinë projektuese për **15** projekte të cilat kanë qenë në kuadër të drejtorateve të tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2022 Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka proceduar me kërkesa për projekte tjera me bashkëfinancim siç janë:

- Asfaltimi i rrugicave në Lipjan dhe Hallaq

Me MAPL në vlerë 40,000.00 euro, projekt dedikuar për komunitetin jo shumicë për asfaltim të rrugicave në Lipjan dhe fshatin Hallaq i Vogël. Në këtë projekt me marrëveshje bashkëfinancimi, Komuna do të participoj në vlerë prej 10,000.00 euro

- Rregullimi i hapsirave publike në Lipjan rreth lumit sitnica nga MAPL në vlerë 78,000.00 euro, ku Komuna e Lipjanit participon me shumën në vlerë 19,000.00 euro.
- Rregullimi i infrastruktures në fshatin Janjevë me MMPHI në vlerë prej 120,000.00 euro dhe Komuna participon vlerën prej 50,000.00 euro.

Gjithashtu Kryetari i Komunës ka nënshkruar marrëveshje bashkëfinancimi me MMPHI në vlerë 300,000.00 euro për projektin: “Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sillovi, Gadime, Smallush, Gumnasellë, Llugagji, Babush”. Lidhur me këto projekte departamenti i infrastrukturës ka aplikuar dhe përgatitur gjithë lëndën për procedura të mëtutjeshme të publikimit të projektit. Komuna sipas marrëveshjes së nënshkruar me Ministrinë do të participoj 494,215.00 Euro.

Departamenti i Infrastrukturës ka përgatitur dhe ka aplikuar edhe në institucione të tjera me projekte konkrete si:

- Ministrinë e Zhvillimit Rajonal “Ndërtimin e infrastrukturës tek Zona Ekonomike e QMI-së”.
- Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë “Faza e tretë e ndërtimit të zonës ekonomike në Kerqevë”.
- Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal “Rregullimi i hapësirave publike në Komunën e Lipjanit – rreth Shtratit të Lumit Sitnica.

Komuna e Lipjanit ka përfituar nga granditë e Performancës (GPK) shumë në vlerë **1,021,108.38 €**, të cilën shumë Drejtorati për Infrastrukturë e ka shpërndarë në disa projekte.

Gjatë kësaj periudhe punimet kanë stagnuar për shkak të ngritjes së çmimeve në projektet që kanë qenë në vazhdim nga vitet paraprake, siç janë:

- Rruga "Marie Shllaku" deri në fshatin Rufc,
- Rehabilitimi i rrugës Lipjan – Rubovc,
- Ndërtimi i rrugës Gryka e shpëtimit - Krojmir
- Asfaltimi i rruges tranzit, lagjeja e Konjuhut deri te rruga regjionale Lipjan - Janjevë

Ndërsa kanë vazhduar me ritëm të ngadalshëm projektet si :

- Salla e sporteve në Lipjan,
- Asfaltimi i rrugicave në Rubovc, Akllap, Banulle, Zllakuqan, Rufc, Krojmir dhe Vershevc faza II.
- Asfaltimi i rrugëve në Lipjan faza III.

Gjatë kësaj periudhe kanë përfunduar të gjitha projektet që kanë qenë një vjeçarë siç janë:

- Mjellja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit dhe rrugët lokale
- Ndërtimi i rrugës Hallaq I Madhe-Rufc I Ri
- Ndërtimi i rrugës Ribar I Madh-Ribar I Vogël
- Aneksat e rrjetit të kanalizimit në Lipjan, Gadime , Dobrajë Madhe faza II
- Aneks në rrjetin e ujësjellsit brenda në qytetin e Lipjanit.
- Ndërtimi i trotuarit me ndriqim publik në Akllap
- Ndërtimi i shtratit të lumit në Ribar të Madh
- Rikonstruimi i rrugës Poturovc- Dobrajë të Madhe
- Ndriqimi publik në Teqe
- Ndriqimi publik në Miren
- Ndërtimi i rrethojave dhe infrastrukturës në varreza
- Ndërtimi i Trotuarëve me ndriqim në Qallapek
- Rikonstruimi i rrugës Zylfie Gashi në Lipjan
- Ndërtimi i Rrugës Bujan- me rrugën për Kraishtë
- Rregullimi i shtratit të Lumit Janjevka në lagjen e Konjuhut në Lipjan
- Renovimi i QMF dhe AMF në Shalë, Magure faza II
- Ndërtimi i fushave të hapura sportive në Gllavic, Marevc

Ndërsa projektet të cilat janë 2 vjeçare, kanë përfunduar punimet për këtë vit kalendarik, ndërsa vazhdojnë punimet në vitin tjetër sipas planit, të cilat janë :

- Ndërtimi i trotuarit me ndriqim publik në Gllavic-Marevc
- Ndërtimi i rrugëve në lagjet e fshatrave Sllovi, Gadime, Smallush , Gomasellë, Llughaxhi, Babushë.
- Ndërtimi i shtratit të lumit në Smallushë
- Vazhdimi i ndërtimit të shtratit të lumit në Gadime
- Ndërtimi i shtratit të lumit në Glllogovc
- Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh(rr.Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)
- Shtigjet e ecjes në Sllovi
- Shtigjet e ecjes në Gadime faza e dytë
- Ndërtimi i palestrës sportive në Glllogovc
- Ndërtimi i ulësve për shikues dhe vendosja e barit artificial në fushat e hapura sportive(Kraishtë, Ribar I Madh, Smallush, Rufc, Gadime e Ulët, Sllovi)
- Ndërtimi i Qerdhes në Shalë
- Ndërtimi i Qerdhes në Rufc te Ri
- Ndërtimi i Këndeve të lojrave për fëmijë (Lipjan, Sllovi, Gadime)
- Ndërtimi i shkollës në Ribar të Madh
- Renovimet e shkollave paralele të ndara (Jeta e re, Konjuh, Vërshevc, Resinovc, Lluga, Gadime e Ulët, Etj.)
- Ndërtimi i parqeve dhe lojrave për fëmijë në shkolla fillore në fshatra

Sektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit përfundimtar të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojmë angazhimin në kuadër të grupit të performancës, pastaj në grupin e punës për ekselencë, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj

Departamenti infrastrukturës ka ndërtuar sistemin elektronik të të dhënave të infrastrukturës në territorin e komunës tone, të cilat të dhëna përditësohen çdo muaj, varsishte nga zhvillimi i ndërtimit të Infrastrukturës në teren. Aktualisht gjendja e infrastrukturës në Komunën tonë në vitin 2022 është:

Asfaltim	13665 m'	53528 m2
Ujesjellesi	2000 m'	
Trotuari	4780m'	6710 m2
Kanalizim	2283 m'	
Ndriqimi	8161 m'	
Drunje Dekorativ	512 Copë	

DREJTORATI PËR INSPEKSION

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë vitit 2022 është punuar në bazë të planit të punës, me dinamizëm të shtuar në secilin sektor të inspektoratit. Pjesë e planit të punës në inspektorat përveç agjendës ishin edhe ankesat – kërkesat e qytetareve të cilat janë shqyrtuar me prioritet në momentin që kanë arritur në zyrën tonë në formë të shkruar, elektronike dhe përmes telefonatave.

Janë realizuar inspektime të vazhdueshme në tërë territorin e komunës. Për realizimin e punëve në drejtori janë organizuar edhe kujdestari (120 kujdestari) dhe kemi realizuar inspektime të ndryshme në bashkëpunimin me Policin e Kosovës – Stacioni Policor në Lipjan.

Në vazhden e inspektimeve janë ndërpre punime të ndërtimeve pa leje, janë rrënuar objekte pa leje ndërtimore, është bërë dislokimi i tregut, zhvendosja e operatorëve – autobusëve nga parkingu te shtëpia e kulturës tek stacioni i autobusëve, inspektimi i linjave të autobusëve dhe auto – taksive, inspektime të vazhdueshme të deponive ilegale.

Inspektori i tregut i cili vepron në kuadër të inspektoratit gjatë vitit 2022 ka mbikëqyr dhe ka zhvilluar inspektime të bazuara në planin e punës për vitin 2022.

Parandalimi i ekonomisë jo formale, inspektimi i bizneseve, mbrojtja e konsumatorëve, ishin objektivat e inspektorit të tregut.

Gjatë vitit 2022 janë realizuar inspektime të ndryshe dhe të shumta, duke përfshi qytetin dhe të gjitha lokalitetet e teritorit komunal.

Objektiv e inspektimeve kanë qenë: lokalet afariste, marketet ushqimore, kafiterit, furrat e bukës, bizneset të cilat merren me prodhimin e qumështit dhe përpunimin e qumështit, shitësit ambulantiv, mullinjtë, inspektim i pompave e derivateve të naftës lidhur me çmimet (kontroll rreth caktimit të çmimit të karburantit) vendosjen e flamujve tregues të origjinës së produktit, afatin e vlefshmërisë së produktit, krahasimin e çmimeve raft – arkë. Inspektim i subjekteve afariste për cilësinë e produktit përkatësisht afatin e vlefshmërisë së produktit, kushtet e ruajtjes së produktit, dhënien e faturave për shërbimet e ofruara të konsumatorëve, certifikatat e kalibrimit të njësive matëse pran organit të licencuar për kalibrim, respektimi i orarit të punës i subjekteve afariste. Të gjitha parregullsitë janë konstatuar me procesverbal dhe është iniciuar procedurë kundërvajtëse në Gjykatën Themelore në Prishtinë – dega në Lipjan.

Rendësi e veçantë i është kushtuar subjekteve ekonomike të cilat nuk kanë qenë të regjistruara në ARBK dhe pa pranime teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko – higjeno – sanitare.

Gjatë këtij viti kemi bërë dislokimin e tregtimit të produkteve jo ushqimore duke zbatuar Vendimin për dislokimin e tregtimit të produkteve jo-ushqimore me 1Nr.333-80223 të datës 26.12.2019, që në tregun aktual të bëhet vetëm tregtimi i produkteve ushqimore, ndërsa të gjitha produktet tjera janë dislokuar në sipërfaqen – lokacionin e ri të përgatitur për treg.

Inspektorët e ndërtimit për gjatë vitit 2022 kanë inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në të gjitha zonat e ndërtimit duke përfshi qytetin dhe periferinë.

Objektivat kryesore të inspektoreve të ndërtimit kanë qenë parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore, kontrollimi i lejeve ndërtimore dhe çertifikatën e përdorimit, kontrolli i zbatimit të lejes ndërtimore, si dhe rrënimin e ndërtimeve pa leje ndërtimore.

Për secilin rast të ndërtimit pa leje janë ndjekur hapat procedural ligjor për ndalim të punimeve. Nga inspektorët e ndërtimit janë realizuar procesverbale, aktvendime, vendosje e shiritit zyrtar, fletëparaqitje, kallëzim penal, si dhe aktvendim për rrënim.

Si rezultat i ndjekjes së hapave procedural ligjor gjatë vitit 2022 kemi të realizuar pesë rrëime dhe katër vetë rrëime. Inspektorët e trafikut përgjatë vitit 2022 kanë ndërmarr disa veprime të cilat kanë shtuar dinamizmin në punë. Bashkëpunim i ngushtë me qytetaret dhe koordinim i shkëlqyer me Policinë e Kosovës – stacioni në Lipjan dhe nën stacionet Magure, Janjevë, kanë dhënë rezultate të shumta.

